

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

P. Nr. 171/13

PP. Nr.: 147/2011

Datë: 13 mars 2014

Aktgjykimi i publikuar mund të mos jetë i formës së prere dhe mund të jetë objekt i ankesës në baze të ligjit të aplikueshëm.

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren, në trupin gjykues përbërë nga:

- 1) Gjyqtari i EULEX-it, Vladimir Mikula, kryetar i trupit gjykues,
- 2) Gjyqtarja e EULEX-it, Franciska Fiser, anëtar i trupit gjykues, dhe
- 3) Gjyqtari Vendor, Refki Piraj, anëtar i trupit gjykues

ndihmuar nga procesmbajtësi i nënshkruar më poshtë, në çështjen penale kundër:

1. **R.M.**, emri i babait R.; data e lindjes x xxx xxxx në fshatin xxx, xxx, mashkull, kombësia shqiptare, shtetësia kosovare, adresa aktuale rruga “xxxxx xxxx” nr. xx, xxxx;
2. **S.P.**, emri i babait I. data e lindjes xx xxxx xxxx në fshatin xxxx, xxx, mashkull, kombësia shqiptare, shtetësia kosovare, adresa aktuale rruga “xxxx” xx nr. Xx; xxx;
3. **A.A.**, emri i babait R., data e lindjes xx xxxx xxx, mashkull, kombësia shqiptare, shtetësia kosovare, adresa aktuale fshati xxx, xxxx;
4. **K.U.**, emri i babait O., data e lindjes xx xxx xxxx në fshatin xxxx, xxxx, kombësia shqiptare, shtetësia kosovare, adresa aktuale fshati xxxx, xxxx;
5. **A.T.**, emri i babait B., data e lindjes xx xxxx xxxx në fshatin xxxx, xxx, kombësia shqiptare, shtetësia kosovare, adresa aktuale rruga “xxx” nr. xx, xxxx;
6. **M.K.**, emri i babait I., data e lindjes xx xxxl xxx në fshatin xxx, xxx, kombësia shqiptare, shtetësia kosovare, adresa aktuale fshati xxx, xxxx.

Të gjithë akuzuar sipas aktakuzës së 26 shkurtit 2013, ushtruar më 27 shkurt 2013 në Gjykatën Themelore të Prizrenit, për veprat penale të mëposhtme siç përshkruhen në aktakuzë:

I. Në periudhën mes 01/07/2008 dhe 29/11/2011 në Prizren, **R.M.** në cilësinë e kryetarit të komunës së Prizrenit dhe **K.U.** në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër, në bashkëkryerje dhe me qëllim të fitimit të dobisë për **M.K.**, **M.Q.** dhe **J.A.**, duke shfrytëzuar autoritetin e tyre zyrtar nuk kanë ekzekutuar detyrat e tyre zyrtare, në veçanti qëllimisht nuk kanë ekzekutuar aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev.nr. 209/2005 të datës 26/05/2006, sipas të cilit Komuna e Prizrenit shpallej pronare e ligjshme e parcelave të tokës nr. 8617 dhe nr. 8619, përkatësisht sipërfaqes prej 0,20.65 ha, në vlerë prej 41,300 EUR dhe 0,06.22 ha në vlerë prej 12.440 EUR në “Bugazillek”, fleta poseduese nr. 8414 ZK Prizren, dhe në veçanti:

1. në periudhën në mes 01/07/2008 dhe fundit të marsit 2010, **K.U.**, pas njoftimit nga Avokati Publik Komunal i Komunës së Prizrenit për aktgjykimin e sipërpërmendur përmes memorandumit nr. 621/08 të datës 01/07/2008 dhe memorandumit të datës 12/11/2008, qëllimisht nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim për të ekzekutuar atë dhe për të bërë ndryshimet e duhura në shënimet kadastrale të cilat do të evidentonin komunën e Prizrenit pronare të ligjshme të parcelave të tokës në fjalë;
2. në periudhën në mes 01/07/2008 dhe 29/11/2011, **R.M.**, pas njoftimit nga Avokati Publik Komunal i Komunës së Prizrenit për aktgjykimin e sipërpërmendur përmes memorandumit nr. 621/08 të datë 01/07/2008, urdhëroi **K.U.** të mos e ekzekutojë atë dhe të mos bëjë ndryshimet e duhura në shënimet kadastrale të cilat do të evidentonin Komunën e Prizrenit pronare të ligjshme të parcelave të tokës në fjalë dhe ka vazhduar të mos e respektojë aktgjykimin deri më 29/11/2011.

Meqë veprimet e lartpërmendura kanë rezultuar në dobi për, të paktën, M.K., M.Q. dhe J.A., në formë të shfrytëzimit dhe të përfitimit të dobisë nga toka e komunës, ato përbëjnë Keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar sipas nenit 422(1) dhe (2)(2.1) dhe (2.2) lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Kosovës.

II. Në periudhën në mes 24/11/2010 dhe 11/02/2011 në Prizren, **R.M.** në cilësinë e Kryetarit të Komunës së Prizrenit, **M.K.** në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë së Administratës/Zyra për Çështje Pronësore Juridike të Komunës së Prizrenit, dhe **A.A.** në cilësinë e ushtruesit të detyrës të drejtorit të drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër të Komunës së Prizrenit, duke vepruar në bashkëkryerje dhe me qëllim të përfitimit të dobisë për Qendrën Edukative Arsimore QEA “Gulistan”, dhe për t'i shkaktuar dëm

personit tjetër juridik, Agjencisë Kosovare të Privatizimit, duke shfrytëzuar autoritetin e tyre zyrtar, kanë tejkaluar kufijtë e autorizimit në procesin e ndarjes së tokës publike “Gulistan-it” dhe në veçanti:

1. më 24/11/2010 me qëllim që t'i ndajnë tokën për investimet e planifikuara nga “Gulistan”, ata i mundësuan Komunës së Prizrenit që në mënyrë të paligjshme të marrë në posedim parcelën e tokës nr. 800/2 në sipërfaqe prej 50.300 m² në vendin e quajtur “Boka Boka” në Prizren në vlerë prej 100.600 EUR, fleta poseduese nr. 553 ZK Korishë, e regjistruar në emër të Organizatës Punuese të Pylltarisë “Sharri”– OPB Ekonomia e Pyjeve, nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, pa pëlqimin e duhur të Agjencisë;
 - a. në datën e lartcekur **R.M.** nxori vendimin nr. 01-370 përmes të cilit Komuna e Prizrenit mori në posedim parcelën e tokës në fjalë;
 - b. në të njëjtën datë **M.K.**, si rrjedhojë e vendimit nr. 03/3, lëshoi kërkesë drejtuar **A.A.** që të bëjë ndryshimet në shënimet kadastrale duke ndikuar në bartjen e pronësisë së parcelës së tokës në fjalë nga Organizata Punuese e Pylltarisë “Sharri”– OPB Ekonomia e Pyjeve në pronësi të Komunës së Prizrenit;
 - c. në të njëjtën datë **A.A.** nxori vendimin nr. 07-025-6976/Z përmes të cilit ai miratoi kërkesën e **M.K.** dhe bëri ndryshimet në shënimet kadastrale duke paraqitur bartjen e parcelës së përmendur nga Organizata Punuese e Pylltarisë “Sharri”– OPB Ekonomia e Pyjeve në pronësi të Komunës së Prizrenit.
2. Më 11/02/2011 me qëllim që t'i ndajnë tokën për investimet e planifikuara nga “Gulistan”, ata mundësuan nënshkrimin e kontratës mes Komunës së Prizrenit dhe subjektit të lartpërmendur përmes të cilës këtij të fundit i dhanë në shfrytëzim në mënyrë të paligjshme parcelën e tokës nr. 800/2:
 - a. në datën e lartpërmendur **R.M.** nënshkroi kontratën nr. 17/01, mbi kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme, me “Gulistan” përfaqësuar nga drejtori i saj T.S. me anë të së cilës subjektit të cekur iu dha në shfrytëzim parcela e tokës për periudhën prej 40 vjet pa kompensim;
 - b. në datën e lartcekur **M.K.**, duke vepruar mbi kontratën e lartpërmendur, lëshoi kërkesë drejtuar **A.A.** që të bëjë ndryshime në shënimet kadastrale me qëllim të regjstrimit së dhënies me qira të parcelës së tokës sipas kushteve të shfrytëzimit të pronës së paluajtshme;
 - c. në datën e lartcekur **A.A.** nxori vendim me anë të cilit miratoi kërkesën e **M.K.** dhe bëri ndryshimet në shënimet kadastrale në mënyrë që të regjistrojë dhënien

me qira të parcelës së tokës së përmendur sipas kushteve të shfrytëzimit të pronës së paluajtshme.

Meqë veprimet e lartcekura nën 1 dhe 2 janë kryer me qëllim të përfitimit të dobisë për “Gulistan”, në formë të shfrytëzimit pa pagesë të pronës së Komunës, dhe po ashtu me qëllim të shkaktimit të dëmit Agjencisë Kosovare të Privatizimit, ato përbëjnë veprën penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar sipas nenit 422(1) dhe (2)(2.1) dhe (2.2) lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

III. Në periudhën mes 15/12/2010 dhe 15/04/2011 në Prizren, **R.M.**, në cilësinë Kryetarit të Komunës së Prizrenit dhe **S.P.** në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor të Komunës së Prizrenit, duke vepruar në bashkëkryerje dhe me qëllim të përfitimit të dobisë për një person juridik, përkatësisht fabrikën e çokollatave N.T.P “Kamila”, duke keqpërdorur autoritetin e tyre zyrtar kanë tejkualuar kufijtë e autorizimeve të tyre në procesin e ndarjes së tokës publike organizatës në fjalë, në veçanti:

1. më 15/12/2010 **R.M.** nënshkroi Marrëveshjen e Partneritetit Publiko-Privat me “Kamila” me seli në Gjakovë, përfaqësuar nga E.S. mbi shfrytëzimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës së Prizrenit për parcelat e ndryshme të tokës në sipërfaqe prej 13.935 m² në Prizren, fleta poseduese nr. 593 ZK Lubizhde, pa marrjen e vendimit paraprak nga Kuvendi Komunal dhe pa i ndjekur procedurat përkatëse ligjore;
2. më 15/04/2011 **S.P.** në bazë të autorizimit dhënë nga **R.M.** nënshkroi kontratën nr. 04-353 me “Kamila” përfaqësuar nga E.S. për “Shfrytëzimin e Tokës Komonale dhe Përcaktimin e Çmimit të Qirasë për Ndërtimin e Ndërtesës – Fabrikës së Çokollatave”, me anë të cilës ia ndau parcelën e tokës nr. 688/2 në madhësi prej 20.000 m² në “Boka Boka” në Prizren në vlerë prej 40.000 EUR, fleta poseduese nr. 257 ZK Lutogllavë, pa marrjen e vendimit paraprak nga Kuvendi Komunal dhe pa i ndjekur procedurat përkatëse ligjore;

Meqë veprimet e lartcekura rezultuan në përfitim për “Kamila”, në formë të shfrytëzimit pa pagesë të pronës së Komunës, pa vendim paraprak nga Kuvendi Komunal, kjo përbën veprë penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar sipas nenit 422(1) dhe (2)(2.1) dhe (2.2) lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

IV. Në periudhën mes 02/08/2011 dhe 26/01/2012 në Prizren, **R.M.**, në cilësinë e kryetarit të Komunës së Prizrenit, **M.K.**, në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë së Administratës/Zyra për Çështje Pronësore Juridike në Komunën e Prizrenit dhe **A.T.**, në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër të Komunës së Prizrenit, duke vepruar në bashkëkryerje dhe me qëllim të shkeljes së rëndë të të drejtave të personave të tjerë, përkatësisht personave që kishin ushtruar padi civile lidhur me pronësi në gjykatën e Prizrenit, në së paku 7 raste, siç janë C 244/11, C 583/11, C 539/11, C 526/11, C 727/06, C 388/11, C 872/08, duke keqpërdorur autoritetin e tyre zyrtar kanë tejkalluar kufijtë e autorizimeve të tyre duke marrë pjesë në nxjerrjen dhe zbatimin e vendimit nr. 01/06-8121 të titulluar “Konkluzion” i datës 02/08/2011 me anë të cilit ekspertët kadastralë të cilët punonin në Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër të Komunës së Prizrenit u ndalohej të merrnin pjesë në shqyrtime gjyqësore dhe dhënia e opinionëve në lëndët e lartpërmendura, në këtë mënyrë kanë penguar realizimin e të drejtave të paditësve për gjykim të shpejtë që do të çonte në kthimin e mundshëm të pronave të tyre, në veçanti:

1. më 02/08/2011 **M.K.** i dorëzoi **R.M.** një propozim për nxjerrjen e Konkluzionit për ndalimin e ekspertëve kadastralë të cilët punonin për Drejtorinë e Gjeodezisë dhe Kadastrës të Komunës së Prizrenit të merrnin pjesë në shqyrtime gjyqësore dhe të jepnin opinionet e tyre të ekspertit në rastet e lartpërmendura;
2. më 02/08/2011 **R.M.**, si pasojë e propozimit të **M.K.**, nxori Konkluzionin sipas të cilit ekspertët kadastralë të cilët punonin në Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër të Komunës së Prizrenit e kishin të ndaluar të merrnin pjesë në shqyrtime gjyqësore dhe të jepnin opinionet e tyre të ekspertit në rastet e lartpërmendura, dhe pavarësisht disa thirrjeve nga gjykata, ai refuzoi të heqë ndalimin deri kur nxori vendimin nr. 01/06 të datës 26/01/2012;
3. më 02/08/2011 **A.T.**, pas Konkluzionit, urdhëroi ekspertët vartës kadastralë të cilët punonin në Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër të Komunës së Prizrenit, t'i bindeshin Konkluzionit i cili në të vërtetë u ndalonte atyre marrjen pjesë në shqyrtime gjyqësore dhe dhënien e opinionëve të tyre të ekspertit në rastet e lartpërmendura.

Meqë veprimet e lartpërmendura rezultuan në shkelje të rëndë të të drejtave të një numri paditësish në konteste civile, ato përbëjnë vepër penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar sipas nenit 422(1) dhe (2)(2.1) dhe (2.2) lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, në praninë e prokurorit publik, të akuzuarve dhe avokatëve të tyre mbrojtës më:

13, 14 dhe 15 gusht 2013;

12, 13, 16, 17 dhe 19 shtator 2013;
10 dhe 24 tetor 2013;
7, 12, 13, 14, 15 dhe 19 nëntor 2013;
13, 16, 17 dhe 19 dhjetor 2013;
27 janar 2014;
10, 11, 12, 13, 14 dhe 25 shkurt 2014;
13 mars 2014

pas këshillimit dhe votimit të trupit gjykues të mbajtur më 13 mars 2013, në bazë të neneve 390 dhe 391 par 1 të KPPK,

NË PAJTIM me nenet 359, 364, 365 dhe 366 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, më 13 mars 2014, në seancë të hapur për publikun dhe në praninë e të pandehurve, avokatëve të tyre mbrojtës dhe prokurorit të EULEX-it, lëshohet si më poshtë

AKTGJYKIM

1. R.M. dhe K.U. shpallen fajtorë për pikën një të aktakuzës

Sepse në periudhën në mes 01/07/2008 dhe 29/11/2011 **R.M.**, në cilësinë e kryetarit të Komunës së Prizrenit, pasi njoftohet lidhur me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. Nr. 209/2005 të datës 26/05/2006 sipas të cilit Komuna e Prizrenit shpallet pronar legjitim i parcelave të tokës nr. 8617 dhe nr. 8619, përkatësisht madhësisë prej 0,20.65 ha në vlerë prej 41.300 EUR dhe 0,06.22 ha në vlerë prej 12.440 EUR në “Bugazillek”, fleta poseduese nr. 8414 ZK Prizren, përmes memorandumit nr. 621/08 të datës 01/07/2008 nga avokati publik i Komunës së Prizrenit, urdhëron drejtorin e Drejtorisë së Gjeodezisë dhe Kadastrës **K.U.** që të mos ekzekutojë vendimin dhe që të mos bënte ndryshimet e duhura në shënimet kadastrale që do të bënin Komunën e Prizrenit pronare të ligjshme të parcelave të tokës në fjalë dhe ka vazhduar të mos respektojë aktgjykimin deri më 29/11/2011 dhe për këtë periudhë M.K., M.Q.dhe J.A., kanë përfituar shumë prej 30.050 Euro nga pronat që do t'i kishin përkitur Komunës.

2. R.M., M.K. dhe A.A. shpallen fajtorë për pikën dy të aktakuzës

Sepse në periudhën në mes 24/11/2010 dhe 11/02/2011 në Prizren, **R.M.** në cilësinë e kryetarit të Komunës së Prizrenit, në mënyrë që të ndajë tokën për investimin e planifikuar nga “Gulistan”, më 24/11/2010 lëshoi vendimin nr. 01-370 përmes së cilit Komuna e Prizrenit mori posedimin e parcelës së tokës nr. 800/2 të madhësisë prej 50.300 m² në vendin e quajtur “Boka Boka” në Prizren në vlerë prej 100.600 EUR, fleta poseduese nr. 553 ZK Korishë, e regjistruar në emër të Organizatës Punuese të Pylltarisë “Sharri”– OPB Ekonomia e Pyjeve, nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, pa pëlqimin e nevojshëm të Agjencisë; më 24/11/2010 si pasojë e vendimit të kryetarit të Komunës **M.K.**, në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë së Administratës/Zyra për Çështje Pronësore Juridike në Komunën e Prizrenit, udhëzoi G. S të nënshkruajë në emër të tij kërkesën nr. 03/3 dërguar **A.A.** që të bënte ndryshimet në regjistrat kadastralë duke ndikuar në bartjen e pronësisë së tokës së përmendur nga Organizata Punuese e Pylltarisë “Sharri”– OPB Ekonomia e Pyjeve të Komuna e Prizrenit; më 24/11/2010 **A.A.**, në cilësinë e ushtruesit të detyrës të drejtorit të Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër të Komunës së Prizrenit, lëshoi vendimin nr. 07-025-6976/Z me të cilin aprovohej kërkesa e M.K. dhe janë bërë ndryshimet në regjistrat kadastral që tregojnë bartjen e pronësisë së tokës së përmendur nga Organizata Punuese e Pylltarisë “Sharri”– OPB Ekonomia e Pyjeve të Komuna e Prizrenit. Më 11/02/2011 **R.M.** nënshkroi kontratën nr. 01/17 me “Gulistan” përfaqësuar nga drejtori i saj T.S. mbi kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme, me anë të së cilës subjektit të përmendur i është dhënë parcela e tokës për shfrytëzim për periudhën prej 40 vjetësh pa kompensim dhe pa qira e cila është 20.120 Euro, në dobi të Gulistan; më 11/02/2011 **M.K.**, duke vepruar në bazë të kontratës së lartpërmendur, udhëzoi G. S të nënshkruajë në emër të tij kërkesën dërguar A.A. për të bërë ndryshime në regjistrat kadastralë në mënyrë që të regjistrojë dhënien me qira të parcelës së tokës së përmendur sipas kushteve të shfrytëzimit të pronës së paluajtshme; më 11/02/2011 A.A. lëshoi vendim me anë të së cilit aprovon kërkesën e M.K. dhe janë bërë ndryshime në regjistrat kadastralë në mënyrë që të regjistrohet dhënia me qira e parcelës së tokës së përmendur sipas kushteve të shfrytëzimit të pronës së paluajtshme dhe kështu ishte vepruar ndonëse nuk ishte kërkuar pëlqimi i Kuvendi Komunal për dhënien e tokës konkrete që parashihet dhe përcaktohet në nenin 3 (a) të Statutit të Komunës së Prizrenit Nr. 01/011-5643 dhe Ligjin Nr. 03/L-226 mbi Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës i cili hyri fuqi më 15/12/2010 dhe në

kundërshtim me nenin 5, par 3 dhe 7 të Ligjit Nr. 03/L-241 mbi Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i datës 30/09/2010.

3. R.M. dhe S.P. shpallen fajtorë për pikën tre të aktakuzës

Sepse më 15/12/2010 **R.M.** në cilësinë e kryetarit të Komunës nënshkroi Marrëveshjen e Partneritetit Publiko-Privat dhe Koncesionet mbi shfrytëzimit të Pronës së Paluajtshme të Komunës së Prizrenit për parcelat e ndryshme të tokës që arrijnë në sipërfaqen e përgjithshme prej 13.935 m² në Prizren, fleta poseduese nr. 593 ZK Lubizhde me “Kamila” me seli në Gjakovë e përfaqësuar nga E.S.pa marrjen e një vendimi paraprak të Kuvendit Komunal dhe pa i ndjekur procedurat përkatëse ligjore, kjo kontratë nuk është realizuar; më 15/04/2011 **S.P.**, në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor të Komunës së Prizrenit, sipas autorizimit të **R.M.**, ka nënshkruar kontratën Nr. 04-353 me “Kamila” përfaqësuar nga E.S. “për Shfrytëzimin e Tokës Komunale dhe Përcaktimin e Çmimit të Qirasë për Ndërtimin e Ndërtesës – së Fabrikës së Çokollatave”, me anë të së cilës i ndan parcelën e tokës Nr. 688/2 në sipërfaqe prej 20.000 m² në “Boka Boka” në Prizren në vlerë prej 40.000 EUR, fleta poseduese Nr. 257 në ZK Lutogllavë, pa marrjen e vendimit paraprak të Kuvendit Komunal dhe pa ndjekur procedurat përkatëse ligjore; kontratat e lartpërmendura rezultuan me dobi prej 4.500 Euro për “Kamila”, në formë të shfrytëzimit pa pagesë të pronës së Komunës, pa vendim paraprak të Kuvendit Komunal dhe pa procedurë prokurimi, siç parashihet dhe përcaktohet në nenin 3 (a) të Statutit të Komunës së Prizrenit Nr. 01/011-5643 dhe Ligjit Nr. 03/L-226 mbi Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës i cili hyri fuqi më 15/12/2010 dhe në kundërshtim me nenin 5, par 3 dhe 7 të Ligjit Nr. 03/L-241 mbi Prokurimin Publik i Republikës së Kosovës i datës 30/09/2010.

4. R.M., M.K. dhe A.T. shpallen fajtorë për pikën katër të aktakuzës

Sepse më 02/08/2011 **M.K.**, në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë së Administratës/Zyra për Çështje Pronësore/Juridike në Komunën e Prizrenit, i dorëzoi **R.M.** propozimin për nxjerrjen e Konkluzionit në mënyrë që të ndalojë ekspertët kadastralë të cilët punonin për Drejtorinë e Gjeodezisë dhe Kadastrës të Komunës së Prizrenit të marrin pjesë në seanca gjyqësore dhe të japin mendimet e tyre në

çështjet civile; më 02/08/2011 **R.M.**, në cilësinë e kryetarit të Komunës së Prizrenit, si rrjedhojë e propozimit të M.K., nxjerr Konkluzion sipas të cilit ekspertëve kadastralë të cilët punonin në Drejtorinë e Gjeodezisë dhe Kadastrës të Komunës së Prizrenit u ndalohet të marrin pjesë në seancat gjyqësore dhe të japin mendimet e tyre të ekspertit në çështjet e lartpërmendura, dhe pavarësisht një numri të thirrjeve nga gjykata, ai refuzoi të heqë ndalimin derisa nxori vendimin Nr. 01/06 më datë 26/01/2012; më 02/08/2011 **A.T.**, edhe pse kishte dijeni se Konkluzioni i tillë është i paligjshëm ai informoi vartësit e tij të cilët punonin në Drejtorinë e Gjeodezisë dhe Kadastrës të Komunës së Prizrenit të cilët respektuan Konkluzionin i cili faktikisht ua ndalonte atyre pjesëmarrjen në seanca gjyqësore dhe dhënien e mendimeve të tyre të ekspertit në çështjet e lartpërmendura. Kjo shkaktoi vonesa në mbarëvajtjen e rasteve civile pronësore të ushtruara në Gjykatën e Prizrenit, në së paku 7 raste, siç janë, C 244/11, C 583/11, C 539/11, C 526/11, C 727/06, C 388/11, C 872/08, duke ndërhyrë në procedurën gjyqësore dhe zbatimin e drejtësisë.

Prandaj

1. **R.M.**, me veprimet e përshkruara nga pika 1 deri 4 në vazhdim, ka kryer veprat penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar sipas nenit 422, paragrafi 1, 2, nën-paragrafi 2.1. dhe 2.2. të Kodit Penal në fuqi nga 1 janari 2013 në vazhdim sipas nenit 81 në fuqi nga 1 janari 2013 dhe pjesërisht në bashkëkryerje sipas nenit 31 të Kodit Penal në fuqi nga 1 janari 2013;
2. **S.P.**, me veprimet e përshkruara në pikën 3, ka kryer veprën penale Shpërdorim i pozitës zyrtare ose autorizimit sipas nenit 339, paragrafi 1, 2 të Kodit Penal në fuqi deri më 1 janar 2013 në bashkëkryerje sipas nenit 23 të Kodit Penal në fuqi nga 1 janari 2013;
3. **A.A.**, me veprimet e përshkruara në pikën 2, ka kryer, veprën penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar sipas nenit 422, paragrafi 1, 2, nën-paragrafi 2.1. dhe 2.2. të Kodit Penal në fuqi nga 1 janari 2013 në bashkëkryerje, sipas nenit 31 të Kodit Penal në fuqi nga 1 janari 2013;
4. **K.U.**, me veprimet e përshkruara në pikën 1, ka ndihmuar në kryerjen e veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar sipas nenit 422, paragrafi 1, 2, nën-paragrafi 2.1. dhe 2.2. të Kodit Penal në fuqi nga 1 janari 2013, sipas nenit 33 të Kodit Penal në fuqi nga 1 janari 2013;

5. **A.T.**, me veprimet e përshkruara në pikën 4, ka ndihmuar, në kryerjen e veprës penale Shpërdorim i pozitës zyrtare ose autorizimit sipas nenit 339, paragrafi 1, 2 të Kodit Penal në fuqi deri më 1 janar 2013, sipas nenit 25 të Kodit Penal në fuqi deri më 1 janar 2013;
6. **M.K.**, me veprimet e përshkruara në pikat 2 dhe 4 në vazhdim, ka kryer veprën penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar sipas nenit 422, paragrafi 1, 2, nën-paragrafi 2.1. dhe 2.2. të Kodit Penal në fuqi nga 1 janari 2013 në vazhdim sipas nenit 81 në fuqi nga 1 janari 2013 dhe në bashkëkryerje sipas nenit 31 të Kodit Penal në fuqi nga 1 janari 2013;

Për arsyet e lartcekura trupi gjykues shqipton dënimet si më poshtë:

1. R.M.

Në pajtim me nenet 41, 49, 50, 52, 73, 81 dhe 422 paragrafi 1 të Kodit Penal të Kosovës në fuqi nga 1 janari 2013, dënohet me 2 vjet burgim me kusht, dënimi nuk ekzekutohet për periudhën e verifikimit prej 3 vjet, sipas nenit 51, paragrafi 2 të Kodit Penal të Kosovës në fuqi nga 1 janari 2013, nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit.

Në pajtim me nenin 65, paragrafi 2 të Kodit Penal të Kosovës në fuqi nga 1 janari 2013 dënohet me 30 muaj ndalim të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik.

2. S.P.

Në pajtim me nenet 34, 42, 43, 44, 64 dhe nenin 339, paragrafi 2 të Kodit Penal të Kosovës në fuqi deri më 1 janar 2013, dënohet me 8 muaj burgim me kusht, dënimi nuk ekzekutohet për periudhën e verifikimit prej 2 vjet, sipas nenit 43, paragrafi 2 të Kodit Penal të Kosovës në fuqi deri më 1 janar 2013, nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit.

Në pajtim me nenin 65, paragrafi 2 të Kodit Penal të Kosovës në fuqi deri më 1 janar 2013, dënohet me 12 muaj ndalim të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik.

3. A.A.

Në pajtim me nenet 41, 49, 50, 52, 73, 75, 76 dhe 422 paragrafi 1 të Kodit Penal të Kosovës në fuqi nga 1 janari 2013, dënohet me 5 muaj burgim me kusht, dënimi nuk

ekzekutohet për periudhën e verifikimit prej 18 muaj, sipas nenit 51, paragrafi 2 të Kodit Penal të Kosovës në fuqi nga 1 janari 2013, nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit.

4. K.U.

Në pajtim me nenet 33, 41, 49, 50, 52, 73, 74, 75 dhe 422 paragrafi 1 të Kodit Penal të Kosovës në fuqi nga 1 janari 2013, dënohet me 8 muaj burgim me kusht, dënimi nuk ekzekutohet për periudhën e verifikimit prej 20 muaj, sipas nenit 51, paragrafi 2 të Kodit Penal të Kosovës në fuqi nga 1 janari 2013, nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit.

5. A.T.

Në pajtim me nenet 25, 34, 42, 43, 44, 64, 65 dhe 339 paragrafi 2 të Kodit Penal të Kosovës në fuqi deri më 1 janar 2013, dënohet me 1 muaj burgim me kusht, dënimi nuk ekzekutohet për periudhën e verifikimit prej 1 vjet, sipas nenit 43, paragrafi 2 të Kodit Penal të Kosovës në fuqi deri më 1 janar 2013, nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit.

6. M.K.

Në pajtim me nenet 41, 49, 50, 52, 73, 75, 76 dhe 422 paragrafi 1 të Kodit Penal të Kosovës në fuqi nga 1 janari 2013, dënohet me 1 vjet e 6 muaj burgim me kusht, dënimi nuk ekzekutohet për periudhën e verifikimit prej 2 vjet, sipas nenit 51, paragrafi 2 të Kodit Penal të Kosovës në fuqi nga 1 janari 2013, nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit.

Në pajtim me nenin 65, paragrafi 2 të Kodit Penal të Kosovës në fuqi deri më 1 janar 2013 dënohet me 18 muaj ndalim të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik.

ARSYETIMI

1. Sfondi i çështjes dhe historiku procedural

Në periudhën mes korrikut 2008 dhe janarit 2012, të pandehurit e lartpërmendur, duke vepruar në cilësinë e personave zyrtarë duke punuar në Komunën e Prizrenit kanë kryer veprën penale në vazhdim Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar. Në veprimin e parë në lidhje me pikën një të aktakuzës R.M. dhe K.U. të dy në cilësinë e personave zyrtarë, respektivisht kryetar i Komunës dhe drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër, nuk ekzekutuan Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, në këtë mënyrë kanë lënë parcelat e tokës në shfrytëzim të M.K., në atë kohë mbante pozitën e nënkryetarit të Komunës së Prizrenit dhe dy individëve tjerë, J.A. dhe M.Q. duke u mundësuar dobi pasurore.

Lidhur me pikën e dytë, R.M. në cilësinë e kryetarit të Komunës së Prizrenit, M.K. në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë së Administratës/Zyra për Çështje Pronësore/Juridike në Komunën e Prizrenit, dhe A.A. në cilësinë e ushtruesit të detyrës të drejtorit të Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër të Komunës së Prizrenit, duke vepruar në bashkëkryerje dhe me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për Qendrën e Edukimit “Gulistan”, në këtë mënyrë i kanë shkaktuar dëm personit tjetër juridik, Agjencisë Kosovare të Privatizimit, duke shfrytëzuar autoritetin e tyre zyrtar i kanë dhënë tokën publike Gulistan-it pa pëlqimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit apo Kuvendit Komunal.

Në aktin e tretë të shpërdorimit të pozitës zyrtare, R.M. në cilësinë e kryetarit të Prizrenit dhe S.P. në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor në Komunën e Prizrenit kanë vepruar në bashkë-kryerje dhe me qëllim të mundësimit të përfitimit financiar për subjektin ligjor, përkatësisht N.T.P. “Kamila” fabrikën e çokollatave, duke tejkaluar kufijtë e autorizimeve të tyre dhe duke dhënë tokë publike organizatës në fjalë pa miratimin e Kuvendit Komunal.

Në aktin e tretë, mes periudhës 02/08/2011 dhe 26/01/2012 në Prizren, i pandehuri R.M. në cilësinë e kryetarit të Prizrenit, M.K. në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë së Administratës/Zyra e Pronës dhe Çështjeve Ligjore në komunën e Prizrenit dhe A.T. në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë së Gjeodezisë dhe Kadastrit në komunën e Prizrenit, duke vepruar në bashkë-kryerje kanë nxjerrë dhe zbatuar përfundimin e kryetarit të komunës, përfundim i cili ndaloi ekspertin kadastral të komunës të marrë pjesë në seancat gjyqësore në cilësi të ekspertit, duke bërë në këtë mënyrë që një numër i caktuar të lëndëve civile në gjykatë të mbesin pezull.

Prandaj, më 15 shtator 2011, fillimisht prokurori nga Zyra e Prokurorisë së Qarkut A.M. nxorri vendim për nisje të hetimeve me numër të referencës HP. Nr. 147/2011 ndaj R.M., N.K., S.P. dhe A.A. për hetim të kryerjes së veprës penale shpërdorim të pozitës zyrtare sipas nenit 339, Kodi Penal i Kosovës, më tutje si 'KPK'.¹

Më 26 shtator 2011, ushtrues detyre i Kryeprokurorit të Qarkut në Prizren S.H. bëri kërkesë te Zyra e Prokurorisë së EULEX-it në Prizren për të marrë lëndën për shkak të faktit se kishin të bënin me zyrtarë të lartë komunalë dhe besimit se lënda ishte tejet e ndjeshme.

Më 29 shtator 2011, prokurori vendor i lëndës në fjalë nxorri edhe një vendim mbi Nisje të Hetimeve HP. No. 255/2011 ndaj R.M., K.U., A.A. dhe A.T. për veprën penale Shpërdorim të pozitës zyrtare apo autorizimit sipas nenit 339, KPK.

Më 3 tetor 2011, ushtrues detyre i kryeshefit të prokurorisë në EULEX, Linda Heaton nxorri vendim për të marrë lëndën dhe i caktoi atë prokurorit nga EULEX Cezary Michalczuk për shqyrtim të mëtutjeshëm.

Pas marrjes së lëndës, pas shqyrtimit të provave më 14 nëntor 2011, Prokurori nga EULEX Cezary Michalczuk nxorri një vendim tjetër mbi nisjen e hetimeve PPN. Nr. 204/11, ndaj R.M.për veprën penale Shpërdorim të pozitës zyrtare apo autorizimit sipas nenit 339, KPK.

Më 14 nëntor 2011, prokurori nga EULEX përgjegjës për lëndën në fjalë, ushtroi parashtresë në gjykatë për të bashkuar hetimet PP. Nr. 147/2011, HP Nr. 255/2011 dhe PPN Nr. 204/11 ndaj gjithë të të pandehurve dhe për të vazhduar me një procedurë të vetme hetimore.

Më 18 nëntor 2011, trupi gjykues i përbërë nga tre gjyqtarë në Gjykatën e Qarkut në Prizren, Kryetari i Trupit Gjykues Fillim Skoro dhe Raima Elezi dhe Kujtim Pasuli në cilësinë e anëtarëve të Trupit Gjykues nxorren vendimin Kp. Nr. 407/2011, më anë të së cilës vendosën se një procedurë e vetme do të zbatohet për të tre hetimet dhe se lënda do të vazhdojë nën numrin Hep. Nr. 147/2011.

Më 23 nëntor 2011, Prokurori i lëndës ushtroi parashtresë te Kryetari i Asamblesë së Gjyqtaqëve të EULEX-it për t'i caktuar lëndën gjyqtarëve nga EULEX dhe më 4 janar 2012, Kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve në EULEX nxorri vendimin JC/EJU/OPEJ/2697/ff/11, sipas së cilit, lënda iu caktua një ekipi prej gjyqtarëve të EULEX-it në Prizren.

¹ Dosja 7

Më 14 mars 2012, Prokurori nga EULEX-i, përgjegjës për lëndën nxorri vendimin mbi zgjerimin e hetimeve ndaj R.M., N.K., S.P., A.A., K.U., A.T. dhe M.K.

Më 20 shkurt 2013, prokurori i sapoemëruar i lëndës Natasha Vicary solli tre vendime të ndara mbi ndërprerjen e pjesërishme të hetimeve sa i përket R.M., N.K. dhe A.A. për veprën penale Shpërdorim të pozitës zyrtare apo autorizimit sipas nenit 422, KPK (kodi i ri penal).

Më 27 shkurt 2013, Prokurori i lëndës ngriti aktakuzë ndaj R.M., S.P., A.A., K.U., A.T. dhe M.K. për veprën penale Shpërdorim të pozitës zyrtare apo autorizimit sipas nenit 422, KPK, për katër aktet e përshkruara në aktakuzë.

Më 25 mars 2013, seanca fillestare është mbajtur në prani të të pandehurve, avokatëve mbrojtës dhe prokurorit. Pas ushtrimit të kundërshtimeve nga ana e avokatëve mbrojtës, ky gjyqtar nxorri vendim për të hedhur poshtë kundërshtimet dhe për të dërguar lëndën në shqyrtim kryesor.

Ankesë ndaj këtij vendimi është ushtruar në Gjykatën e Apelit dhe më 29 maj 2013, pa shqyrtimit të të përmendurës, Gjykata e Apelit nxorri vendimin PN. Nr. 372/13 duke anuluar vendimin e kryetarit të trupit gjykues dhe duke dërguar lëndën për rishqyrtim.

Pas vendimit të Gjykatës së Apelit, ky kryetar i trupit gjykues, pas rishqyrtimit, nxorri një vendim tjetër më 14 qershor 2013 duke dërguar lëndën në shqyrtim kryesor. Pas kundërshtimeve të ushtruara nga avokatët mbrojtës dhe mendimit të prokurorit më 25 korrik 2013, Gjykata e Apelit solli vendim duke konfirmuar vendimit e kryetarit të trupit gjykues dhe duke dërguar lëndën në shqyrtim kryesor.

Shqyrtimi kryesor i kësaj lënde filloi më 13 gusht 2013 dhe pas mbajtjes së 28 seancave, më 13 mars 2014, trupi gjykues shpalli aktgjykimin.

2. Provat e administruara

Gjatë shqyrtimit kryesor, provat si në vijim janë pranuar dhe administruar nga trupi gjykues;

Dosja Nr. 3

- Shpallja e veprave penale nga dega e LDK-së në Prizren, më datë 14.06.2011. nënshkruar nga R.H., këshilltar komunal;
- Shpallja nga R.H., më datë 20.06.2011;

- Shpallja nga R.H., më datë 27.06.2011;
- Shpallja nga R.H., më datë 19.12.2011, që të gjitha të listuara në faqe 837-882;
- Përgjigja e Agjencisë së Privatizimit në Kosovë, më datë 12.01.2012;
- Përgjigja nga M.K. në Prokurori, më datë 27.02.2010 mbi organizimin e brendshëm të komunës;
- Vendimi mbi vendimin e organizimit të brendshëm dhe strukturës së komunës, faqe 883-959;
- Vendimi i kryetarit të komunës mbi emërimin e M.K. drejtor të administratës, më datë 8.04.2008 (978 faqe);
- Vendimi i kryetarit të komunës mbi emërimin e K.U. drejtor të zyrës së kadastrit dhe gjeodezisë, më datë 16.01.2008 (1006 faqe);
- Vendimi i kryetarit të komunës mbi emërimin e A.A. drejtor të Kadastrit dhe Gjeodezisë pas pensionimit të K.U., më datë 1.04.2010 (1015 faqe)
- Vendimi i kryetarit të komunës mbi emërimin e A.T. drejtor të Kadastrit dhe Gjeodezisë, më datë 1.02.2011 (1050 faqe)

Dosja Nr. 4

- Vendimi i bordit të drejtorëve mbi planifikimin urban për t'i lejuar M.K. të ndërtojë një ndërtesë të re, më datë 1.02.2001;
- Kopje e planit dhe lista poseduese e parcelës në emër të M.K. (1132 faqe);
- Lista poseduese e motrave Kullak (1134-1138);
- Kontrata mbi transaksionin e parcelës, më datë 25.06.2001 (J.A., pronari i parcelës, afër M.K.t);
- Kontrata mbi transaksionin e parcelës mes disa shitësve dhe M.K. si blerës (1151-1154);
- Kontrata mbi transaksionin e parcelës nga disa shitës, M.Q. (1158) (që të tre kontratat janë parcela të ndara nga tërësia e parcelës që i përket komunës, dhe të cilat i janë nënshtruar vlerësimit nga Aktgjykimi i Gjykatës Supreme);
- Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prizren C. Nr. 724/01, më datë 9.12.2004;
- Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. Nr. 255/2005, më datë 11.08.2005;
- Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. Nr. 209/2005, më datë 25.05.2006 (1174);
- Vendimi i Gjykatës Komunale në Prizren C. Nr. 790/06, më datë 17.11.2006;
- Vendimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac. Nr. 85/2007, më datë 2.04.2007;
- Vendimi i Gjykatës Supreme Rev. Nr. 250/2007, më datë 6.06.2011;
- Vendimi i Gjykatës Komunale në Prizren C. Nr. 930/07, më datë 3.05.2008;

- Letër nga Avokati Publik Komunal i Prizrenit adresuar Drejtorisë së Gjeodezisë dhe Kadastrit për të t'iu bindur aktgjykimit të Gjykatës Supreme, më datë 12.11.2008 (1213);
- Contratë mbi Qiradhënie – M.Q. dhe N.S, më datë 28.04.2009;
- Contratë mbi Qiradhënie – J.A. dhe 'K.S. Siguria', më datë 30.11.2009;
- Contratë mbi Qiradhënie – M.K. dhe Kompania e Sigurimeve 'E.', më datë 14.04.2010; (kontratat më lart janë përdorur për të vlerësuar dëmin e shkaktuar komunës 1215-1234);
- Memorandum i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, më datë 29.03.2011;
- Kërkesa për shqyrtim nga M.Q. adresuar komunës së Prizrenit, më datë 12.12.2011;
- Kërkesë e Avokatit Publik Komunal **B.M.** adresuar Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër të veprojë në pajtim me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, më datë 16.11.2011 (1253);
- Letër nga drejtori për Gjeodezi dhe Kadastër A.T. bashkëpunëtorit profesional **B.B.** për të vepruar dhe bashkuar parcelat kadastrale, më datë 16.11.2011 (1257);
- Vendimi i drejtorit për Gjeodezi dhe Kadastër A.T. duke aprovuar kërkesën e avokatit publik komunal për të zbatuar aktgjykimin e Gjykatës Supreme, më datë 29.11.2011 (1259);

Dosja numër 5

- Procesverbal i seancës së Bordit të Drejtorëve të Komunës, më datë 13.04.2007;
- Përfundimi i nxjerrë nga M.M. më datë 10.08.2007 për dhënien e tokës Qendrës Edukative "Gulistan";
- Kërkesa e Qendrës Edukative "Gulistan" për dhënie të tokës më datë 13.05.09;
- Procesverbal i takimit të Kuvendit Komunal më datë 18.06.2009;
- Vendimi mbi dhënien e tokës për ndërtim dhe shfrytëzim të përhershëm nga kryetari i kuvendit më datë 18.06.2009;
- Shembull i marrëveshjes në mes shkollës "Gulistan" dhe një studenti;
- Vendimi i kryetarit të komunës më datë 24.11.2010 për bartje të tokës nga organizata punuese e pylltarisë 'Sharri' në komunë;
- Letër nga M.K. Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër për të bërë ndryshime në tokën në pajtim me vendimin e kryetarit të komunës më datë 24.11.2010;
- Vendimi i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër mbi aprovimin e bartjes së tokës nga organizata punuese e pylltarisë 'Sharri' në komunën e Prizrenit;
- Kopje e listës poseduese në emër të Komunës së Prizrenit;
- Kontrata e Kryetarit të Komunës në Prizren dhe Qendrës Edukative "Gulistan" 11.02.2011;

- Kërkesa e M.K. për të regjistruar parcelën në emër të përdoruesit të Kuvendit Komunal për 40 vjetë Q.E. “Gulistan”;
- Vendimi i A.A. për të aprovuar kërkesën e M.K. për të regjistruar parcelën e tokës për qira 40 vjet Q.E. “Gulistanit” më datë 11.02.2011;
- Kopje e çertifikatës së listës poseduese në emër të ri;
- Kontrata ndërtimore në mes Q.E. “Gulistan” dhe një kompanie private më datë 15.02.2011;
- Përfundimi i nxjerrë nga Komuna Q.E. “Gulistan” për pagesë të tatimit;
- Vendimi i Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Hapësinor për të lejuar ndërtime në ndërtesën e re të Q.E. “Gulistan”;
- Ftesë në takim të kryetarit të komunës më drejtorët e komunës dhe procesverbali i agjendës mbi vendimet e marra me përfundimet e pabashkangjitura (pika 8);
- Përfundimi i nxjerrë nga kryetari i komunës R.M. më datë 19.04.2011 mbi aprovimin e planit rregullativ urban në “Boka Boka”;
- Procesverbali i takimit të Komitetit të Politikës dhe Financave të Komunës më datë 15.06.2011;
- Procesverbali i takimit të Kuvendit Komunal të Komunës më datë 16.06.2011;
- Memo i PSRK-së dërguar Zyrës së Prokurorisë Publike të Qarkut më datë 27.06.2011 lidhur me pretendimin e dërguar në PSRK nga këshilltari komunal;
- Procesverbali i takimit të Kuvendit Komunal më datë 7.07.2011;
- Vendimi i kryetarit të kuvendit komunal të komunës më datë 29.07.2011 për të ndryshuar lokacionin e fshatit Nashec në vendin e quajtur “Boka Boka”;
- Vendimi i kryetarit të Kuvendit Komunal për të vënë në diskutim dhënien e tokës në “Boka Boka”;
- Vendimi i S.P. për të kompensuar anëtarët e komisionit më datë 14.02.2011
- Vendimi i S.P. më datë 19.12.2011 për të përdorur ndërtesën e shkollës nga Q.E. “Gulistan”
- Sqarimi mbi mënyrën e mbajtjes së takimit në pajtim me ligjin mbi vetë-qeverisje;
- Përgjigja në Zyrën e Prokurorisë së EULEX-it në Prizren nga Agjencia Kosovare e Pylltarisë;
- Vendimi për aprovim të planit rregullativ urgan nga kryetari i kuvendit më datë 29.02.2012;

Dosja numër 6

- Kërkesë nga përfaqësuesi i “Kamillës” komunës për dhënien e tokës më datë 10.05.2010;

- Marrëveshje mbi partneritetin publik provat dhe lëshimin për shfrytëzim të pronës (parcelë) në mes të kryetarit të komunës si përfaqësues të komunës dhe fabrikës së çokollatave “Kamilla”, më datë 15.12.2010/Plani i biznesit për “Kamila” Kosova;
- Vendimi Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Hapësinor më datë 4.03.2011 për të lejuar Kamillën të ndërtojë një ndërtesë të përkohshme për prodhim të çokollatave dhe ëmbëlsirave;
- Kontratë për shfrytëzim të tokës komunale dhe marrëveshja e qirasë më datë 15.04.2011 dhe lista poseduese e parcelës në emër të komunës;
- Përgjigje e kryetarit të komunës ankuesit R.H. lidhur me dhënien e tokës “Kamilës” më datë 13.07.2011;
- Propozim nga S.P. Kryetarit të komunës më datë 1.08.2011 për vendimin për t’i dhënë tokën “Kamilës”;
- Përfundimi i kryetarit të komunës për të vazhduar me dhënien e tokës në Komitetin për Politikë dhe Financa për shqyrtim dhe vendimi më datë 2.08.2011;
- Plani i “Kamilës” për investim më datë 4.11.2010;
- Raporti i ekspertit nga A.Sh. lidhur me vlerën e parcelës së tokës së dhënë dhe dëmin e shkaktuar komunës;
- Takimi i Bordit të Drejtorëve në Kuvendin e Prizrenit;
- Propozimi për agjendë dhe procesverbali i takimit;
- Përfundimi i kryetarit të komunës duke urdhëruar Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastrë për të nxjerrë vendimin që ndalon ekspertët kadastral nga kryerja e ekspertizës gjyqësore në seanca gjyqësore më datë 2.08.2011;
- Letër për Gjyqtarin V.T. duke informuar disa institucione të ndryshme gjyqësore mbi ndalimin e sjellë nga kryetari i komunës, më datë 1.09.2011;
- Shembull i kontratës, procesverbali i seancave në lëndë të ndryshme që janë mbështetur tek ekspertët kadastralë;
- Letër nga kryetari i Gjykatës së Qarkut në Prizren më datë 7.09.2011 kryetarit të komunës duke kërkuar shqyrtim të vendimit/përfundimit;
- Raporti i kryetarit të Kuvendit Komunal H.D. në zyrën e Prokurorisë mbi ndalimin e ekspertëve kadastralë më datë 21.09.2011;
- Padi dhe seanca të ndryshme që përfshijnë ekspertë kadastralë;
- Raport nga Banka Qendrore e Kosovës mbi të ardhurat e K.U.;
- Raport nga Banka Qendrore e Kosovës mbi të ardhurat e R.M.;
- Raport nga Banka e Biznesit Privat dhe Raiffeisen Banka mbi R.M., K.U. dhe A.A.;
- Raport nga TEB banka adresuar Bankës Qendrore në Kosovë lidhur me A.A. dhe A.T., më datë 8.12.2011;
- Raport nga Banka Ekonomike në Kosovë lidhur me llogaritë e të gjithë të pandehurve më datë 8.12.2011;
- Raport nga NLB Prishtina Banka;

- Raport nga Procredit Banka më datë 13.12.2011;
- Raport nga BKT banka më datë 13.12.2011;
- Raport nga Banka Qendore në Kosovë dërguar Policisë së Kosovës më datë 16.12.2011;
- Kërkesë nga hetuesi i policisë dërguar për regjistrim komunal të veturës më datë 29.11.2011;
- Përgjigje nga Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër Policisë së Kosovës më datë 29.11.2011;
- Përgjigje për Qendrën për Regjistrim të Veturave hetuesit të policisë më datë 30.11.2011;
- Raport nga hetuesi i policisë Zyrës së Prokurorisë së EULEX-it më datë 20.12.2011;
- Kërkesë nga hetuesi i policisë dërguar Bankës Qendrore në Kosovë më datë 2.12.2011;
- Autorizimi nga Zyra e Prokurorisë së Qarkut në Prizren hetuesit të policisë për të kryer marrjen në pyetje/disa letra autorizuese nga Prokurori i EULEX-it hetuesit;
- Kërkesë nga Zyra e Prokurorisë së Qarkut në Prizren policisë për të mbeldhur informata më datë 24.06.2011;
- Përgjigje e hetuesit Zyrës së Prokurorisë së Qarkut në Prizren, më datë 2.09.2011;
- Raport i hetuesit të policisë Zyrës së Prokurorisë së Qarkut në Prizren, më datë 13.09.2011;
- Raporte të ndryshme nga hetuesit e policisë Zyrës së Prokurorisë së Qarkut në Prizren;

Dosja e shqyrtimit kryesor II

- Parashtesa e avokatit R.B. për prova të reja: Kërkesa nga bashkësia lokale kryetarit të komunës për të vepruar në lokacionin “Boka Boka” dhe të pastrojë lokacionin nga mbeturinat; lista e punëtorëve në fabrikën “Kamila” dhe propozimi për të dëgjuar dëshmitarë të rinj;
- Propozimi nga avokati S.M. për të dëgjuar dy dëshmitarë shtesë;
- Propozimi i avokatit R.H. të dëgjohej një zyrtar ligjor nga Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe parashtesa e disa shembujve të regjistrimit të pronës në zyrën kadastrale;
- Prova shtesë të dorëzuara nga S.P. (dosja numër 3)

3. Dëshmitarët e dëgjuar dhe të pandehurit

Gjatë shqyrtimit kryesor janë dëgjuar dëshmitarët si në vijim:

Më 15 gusht 2013 janë dëgjuar M.Q. dhe N.K.;

Më 12 shtator 2013 janë dëgjuar **B.M.**, **A.H.**, **E.M.** dhe **B.B.**;

Më 13 shtator 2013 dëshmitari **B.B.** vazhdoi marrjen e tij në pyetje;

Më 16 shtator 2013 u dëgjuan dëshmitarët **J.A.** dhe R.H.;

Më 17 shtator 2013 dëshmitari R.H. vazhdoi marrjen në pyetje, **F.H.**, **S.A.**, **G.S.** dhe **E.S.**;

Më 10 tetor 2013 u dëgjuan dëshmitarët **Y.H.**, **I.K.**, **L.R.** dhe **R.S.**;

Më 7 nëntor 2013, u dëgjuan dëshmitarët **M.K.**, **A.Sh.**, **A.T.**, **A.T.**, **R.A.** dhe **V. I.**;

Më 12 nëntor 2013, u dëgjuan dëshmitarët **B.S.**, **K.G.**, **I.K.** dhe **S.R.** si dhe deklarata e **H.D.** është futur në procesverbal me pëlqimin e palëve;

Më 13 nëntor 2013 dëshmitari **V.D.** ka dhënë dëshmi dhe palët janë pajtuar që deklarata e dëshmitarit **R.G.** të futet në procesverbal për shkak të padisponueshmërisë së tij për shkak të sëmundjes;

Më 14 dhe 15 nëntor 2013 i pandehuri R.M. dha dëshmi;

Më 19 nëntor 2013 i pandehuri A.T. dha dëshmi;

Më 13 dhjetor 2013 A.T. përfundoi së dhëni dëshmi dhe pastaj i pandehuri **S.P.** dha dëshmi;

Më 16 dhjetor 2013 i pandehuri A.A. dha dëshmi;

Më 17 dhjetor 2013 i pandehuri M.K. dha dëshmi;

Më 19 dhjetor 2013 i pandehuri K.U. dha dëshmi;

Më 27 janar, 10, 11, 12, 13, 14, 25 dhe 27 shkurt 2014, Trupi Gjykses dëgjoji fjalët përfundimtare të palëve dhe më 13 mars 2014 publikisht shpalli aktgjykimin.

Kërkesa për ish-drejtorin e Shkollës “Gulistan”, **T.S.** është hedhur poshtë për shkak të mosdashjes së tij të udhëtojë në Kosovë në njërin anë dhe në anën tjetër, mungesës së nevojës kur të gjitha faktet janë dëshmuar mjaftueshëm nga prova të tjera materiale.

4. Gjetjet faktike

Gjetjet faktike, akuza 1

Mes periudhës 25/06/2001 dhe 27/06/2001, okupesit dhe pronarët e pretenduar të parcelave të tokës Nr 8617 dhe 8619, përkatësisht të madhësisë 0.20,65 ha dhe 0,06.22 ha në “Bugazillek”, lista poseduese Nr. 8414 CZ Prizren, përkatësisht tre vëllezërit/motrat **N.M.**, **A.K.** dhe **G.K.**, kanë ndarë parcelën e tokës Nr 8619 dhe e kanë shitur atë në tre pjesë: parcela Nr 8619/4 në sipërfaqe prej 184 m² M.Q. për 55.200 DM – kontrata Leg. Nr 2475/2001, parcela nr. 8619/1 në sipërfaqe prej 193 m² M.K. për 57.900 DM – kontrata Leg. Nr 2474/2001, dhe parcela Nr. 8619/2 në sipërfaqe prej 137 m² J.A. për 41.100 DM kontrata Leg. 2451/2001.

Më 2004, komuna e Prizrenit pretendoi pronësi mbi parcelat e tokës dhe **N.M.**, **A.K.** dhe **G.K.** ushtruan padi civile në Gjykatën Komunale në Prizren ndaj komunës së Prizrenit duke pretenduar pronësi mbi këto parcela. Më 09/12/2004, Gjykata Komunale në Prizren nxorri aktgjykimin C. Nr. 724/2001 duke përcaktuar **N. M.** in, **A.K.** dhe **G. K.** si pronarët e ligjshëm të tokës në fjalë nëpërmjet trashigimisë.

Më 11/08/2005, Gjykata e Qarkut në Prizren konfirmoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale me Aktgjykimin Ac. Nr. 255/2005, më datë 11/08/2005. Avokati Publik i Komunës së Prizrenit **E.M.** ushtroi masë të jashtëzakonshme ndaj këtij aktgjykimi, ndaj së cilës Gjykata Supreme e Kosovës në Aktgjykimin Rev. Nr. 209/2005 më datë 26/05/2006 prishi aktgjykimin e shkallës së parë dhe atë të dytë dhe shpalli komunën e Prizrenit si pronar të ligjshëm të parcelave në fjalë. Dispozitivi i Gjykatës Supreme në mënyrë të qartë theksoi se ky ndryshim pronësie duhet të regjistrohet në Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër të Komunës së Prizrenit.

E.M. në cilësinë e tij si avokat publik i Komunës së Prizrenit adresoi memorandumun e tij Nr. 621/08 më datë 01/07/2008 Kryetarit të komunës së Prizrenit **R.M.**, Drejtorit të Administratës dhe Personelit, Zyrës për Pronë dhe Çështje Ligjore **M.K.** dhe Drejtorit të Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër **K.U.**, duke i informuar mbi natyrën detyruese të aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev. Nr. 209/2005 më datë 26/05/2006 dhe sugjeroi të ekzekutohet Aktgjykimi nëpërmjet Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër.

Në një memorandum të veçantë, Nr. 622/08 më datë 01/07/2008, të cilën e adresoi vetëm te Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, propozoi të ndryshohen të dhënat kadastrale në pajtim me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme. Kjo përkthehet në ndërmarrjen e ndryshimeve përkatëse në të dhënat kadastrale duke treguar se Komuna e Prizrenit është pronari i ligjshëm të parcelave të tokës në fjalë. Më 12/11/2008, Zyra e Avokatit Publik Komunal dërgoi një letër zyrtare përkujtuese Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër, nënshkruar nga **A.H.** dhe nëpërmjet së cilës letër është kërkuar nga Drejtoria të dërgojë informatë mbi ekzekutimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, por prap nuk është ndërmarrë ndonjë veprim.

Në deklaratën e tij më datë 14 dhjetor 2011 (deklarata e tillë është konfirmuar në dëshminë e tij më 12 shtator 2013) **E.M.** tha se **R.M.** apo **K.U.** asnjëherë nuk iu përgjigjën për të diskutuar memorandumet e tij më datë 01/07/2008.

K.U. asnjëherë nuk i dha memorandumet apo Aktgjykimin e Gjykatës Supreme avokatit kadastral për vlerësim dhe zbatim.

Një hipotekë

Letra Nr 07-029-983/Z më datë 25/01/2012, dërguar nga Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër i Komunës së Prizrenit konfirmoi se vetëm toka parcelë nr. 8619/2 regjistruar për J.A. është vënë në hipotekë. Parcelat e tjera të tokës, përmendur në aktgjykimin e Gjykatës Supreme nuk ishin vënë në hipotekë.

Në deklaratën e tij, më datë 14 dhjetor 2011 (deklarata e tillë është konfirmuar në dëshminë e tij më 12 shtator 2013) **E.M.** se R.M. e as K.U. asnjëherë nuk iu përgjigjën atij për të diskutuar memorandumet e tij më datë 01/07/2008.

B.B., avokat kadastral, dëshmoi se memorandumet 621/08 më datë 01.07.2008 dhe Nr. 622/08 më datë 01.07.2008 janë regjistruar në mënyrë të rregullt, por se ai kurrë nuk i pranoi ato. Ai deklaroi se fakti se këto janë regjistruar siç duhet garanton se ato kanë arritur në zyrën e drejtorit, K.U., dhe se janë ndaluar aty.

Sipas nenit 62.2 të Ligjit Nr. 03/L-040 mbi vetë-qeverisjen lokale më datë 20/02/2008 (LVQL) ngase kryetari i komunës R.M. kishte fuqinë për të punësuar dhe për të larguar nga puna K.U. si drejtor të Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër dhe poashtu kishte të drejtë t'i jepte udhëzime atij lidhur me ekzekutimin e detyrave të Drejtorisë, neni 13, of the LVQL. Siç duket, kryetari i komunës ka udhëzuar **U.**, por në mënyrë të atillë që shkeli ligjin dhe përbën vepër penale.

Mes periudhës 01/07/2008, që nga momentin kur K.U. është këshilluar në mënyrë të drejtpërdrejtë të ekzekutojë aktgjykimin e Gjykatës Supreme në memorandumin Nr. 622/08, dhe derisa ai është larguar nga zyra në fund të marsit 2010, **U.** nuk ekzekutoi aktgjykimin. Në fakt, **U.** nxorri një “ndalim” lidhur me trajtimin e tokës në fjalë, që do të thotë se në kadastër nuk mund të bëhen ndryshime lidhur me këto parcela. Kjo është konfirmuar nga **B.B.**, avokati kadastral nga 2007, i cili ka dhënë dëshmi më 12 dhe 13 shtator 2013, duke konfirmuar ekzistimin e ndalimit dhe duke deklaruar se ai ka supozuar se ndalimi është urdhëruar nga K.U.² A.T. më vonë pezulloi ndalimin³ pas nisjes së hetimeve.

M.K., drejtor i Administratës dhe zëvendës kryetar komune nga 10 nëntor 2008, ishte në posedim të një parcele të tokës në fjalë, parcela 8619/1, dhe po ndërtonte në atë tokë. M.K. ishte në dijeni (sipas provave) për aktgjykimin e Gjykatës Supreme dhe bartjen e paraparë të tokës. R.M. ishte në dijeni se **K.** po e shfrytëzonte tokën e komunës dhe e udhëzoi **U.** të mos ekzekutonte aktgjykimin, dhe në vend të kësaj të lejonte **K.** të vazhdojë të përfitojë nga shfrytëzimi i tokës së komunës.

² Shih faqe 52, 53 të dëshmisë, **B. B.**, më datë 12 shtator 2013;

³ Shih faqe 54 të dëshmisë, **B. B.**, më datë 12 shtator 2013;

Në dëshminë e tij të dhënë më 12 shtator 2013, avokati publik **A.H.** konfirmoi këtë – ai tha se arsyeja për mosekzekutim të aktgjykimit ishte se një ndër zyrtarët e komunës, M.K., ishte pronar i njërës nga parcelat në fjalë.

Përfitimi

M. dhe **U.** evpruan në përfitim të atyre që po përdornin tokën, përfshirë këtu edhe kolegün e tyre nga komuna dhe në dëm të komunës së Prizrenit. Palët e treta janë lejuar në mënyrë të paligjshme të përdorin tokën e komunës duke mos lënë komunën të shfrytëzojë të drejtën e saj për të përdorur, lënë me qira apo për të shitur parcelat e tokës në fjalë.

- M.K. ndërtoi shitore në pronë dhe më vonë lëshoi me qira këto shitore qiramarrësve të ndryshëm. Ekziston një kontratë mes M.K. dhe Kompanisë së Sigurimeve “**E.**”, nënshkruar më 14/04/2010⁴ për një periudhë kohore prej 5 vjetëve, qiraja mujore prej 850 Euro. Gjatë periudhës së përmendur (në fakt, vetëm 17 muaj, nga 14/04/2010 deri më 29/11/2011, Gjykata nuk mbuloi muajin e parë për shkak të kushteve mbi të cilat është arritur pajtim dhe intepretimit të kontratës 3.1, ne veçanti neni 3.1.) shuma e qirasë së pranuar ishte 14450 Euro;
- M.Q. lëshoi pronën me qira, një qebaptore dhe një kompani të sigurimeve. Ekziston një kontratë mes saj dhe N.St, e nënshkruar më 28 prill 2009⁵, kohëzgjatja prej “një periudhe tjetër prej 5 vjetëve”, qiraja mujore prej 100 Euro. Nga 28 prill 2009 deri më 29.11.2011 – afërsisht 31 muaj –ajo pranoi qiranë prej 3100 Euro. Një pjesë tjetër e pronës është dhënë me qira nga dhëndri/kunati i saj. Kjo është dëshmuar me kontratë më datë 01.01.2011, lidhur mes **B.Q.** dhe Kompanisë së Sigurimeve “**K.S. SIGAL**”,⁶ kohëzgjatja 1 vit, qiraja mujore 300 Euro. Nga 01.01.2011 deri 29.11.2011, më shumë se 11 muaj – ata pranuan shumë prej më shumë se 3300 Euro. Prandaj, shuma e përgjithshme prej 6,400 qira është pranuar gjatë periudhës në fjalë.
- J.A. lëshoi me qira pronën e tij dy kompanive të sigurimit, përkatësisht “**K.S-Siguria**” dhe “**Kosovo e Re**”. Kjo është dëshmuar nëpërmjet kontratës së lidhur mes tij dhe “**K.S. Siguria**”⁷ nga 1 dhjetori 2009 deri 01.01.2011 dhe me “**Kosova e Re**”⁸ nga 01.01 2011. Ai pranoi qiranë mujore prej 400 Euro nga 1 dhjetori 2009

⁴ Shih faqe 1224 (verzioni anglisht) 1228 (verzioni shqip) të dosjes së lëndës;

⁵ Shih faqe 1215 (verzioni anglisht) 1216 (verzioni shqip) të dosjes së lëndës;

⁶ Shih faqe 1231 (verzioni anglisht) 1233 (verzioni shqip) të dosjes së lëndës;

⁷ Shih faqe 1218 (verzioni anglisht) 1220 (verzioni shqip) të dosjes së lëndës;

⁸ Shih faqe 1222 (verzioni anglisht) 1223 (verzioni shqip) të dosjes së lëndës;

deri 29 nëntor 2011, pra 23 muaj, duke marrë pra kështu shumën e përgjithshme prej 9 200 Euro.⁹

Prandaj, shuma prej 30050 Euro përfitim është dhënë gjatë periudhës në fjalë. Shuma e tillë përbën fitimin e humbur të pronarit të ligjshëm dhe të hyra të qirasë së paligjshme. Gjykata nuk ka reflektuar mbi vlerën e pronës për përlogaritje të dëmit. Lidhja kauzale mes veprimit të paligjshëm të R.M. dhe K.U. dhe dëmit ndaj komunës ka të bëjë vetëm me vlerën e fitimit të humbur nga qeraja. Mungesa e ekzekutimit të aktgjykimit faktikisht do të thotë rritja e të hyrave nga qiraja çdo muaj por jo zbritja e vlerës së pronës së komunës së Prizrenit. Sipas parimit “**Superficies solo cedit – surface yields to ground**” ndërtesat i takojnë pronarit të tokës. Edhe pse ky parim nuk mund të implikohet pa përjashtim, në këtë rast, ndërtuesi i tokës ishte në dijeni për aktgjykimin e Gjykatës Supreme (këtë dijeni gjykata e nxorri nga fakti se M.K. është person që punon në komunë dhe se ishte mjaft në dijeni lidhur me aktgjykimin në fjalë). Ndërtesat tashmë të ndërtuara duhet kompensuar pronarit të tokës nga ndërtuesi.

Më 16/11/2011 **B.M.**, Avokati Publik i komunës së Prizrenit, i cili kishte filluar punën më 01/11/2011 i dërgoi Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër kërkesën për të ekzekutuar aktgjykimin e Gjykatës Supreme si lënda kadastrale Nr. 027-1949/B. Në dëshminë e tij më datë 12 shtator 2013, **B.M.** tha se ai rastësisht është vënë në dijeni për lëndën duke u ftuar në Gjykatën Komunale në Prizren.¹⁰ Që ditën e njëjtë, A.T. atëherë drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër nxorri kërkesën Nr. 07-029-12903/Z duke urdhëruar Avokatin Kadastral **B.B.** të vlerësojë lëndën në pajtim me ligjin dhe urdhëroi punonjësit kadastralë **E.H.**, **L.SH.** dhe **A.L.** të anulojnë ndalesën ekzistuese mbi pronën në fjalë dhe të ekzekutojnë vendimin e tij.

Më 23/11/2011 Raiffeisen Banka dërgoi një letër Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër në Prizren duke thënë se borgji prej 120.000 Euro e J.A. është paguar dhe se hipoteka mbi parcelën e tokës Nr 8619/2 në sipërfaqe prej 137 m² duhet pezulluar dhe shënuar në të dhënat kadastrale.

Më 29/11/2011 A.T. nxorri vendimin Nr. 07-029-12903/Z duke aprovuar ndryshimet në të dhënat kadastrale sipas aktgjykimit të Gjykatës Supreme. Ai nënshkroi vendimin së bashku me **B.B.** Më 12/12/2011 janë lëshuar lista të reja poseduese për parcelat e tokës Nr. 8617 dhe 8619 CZ në Prizren. Tashmë, komuna e Prizrenit është regjistruar si pronar i ligjshëm i tyre.

Kërkesat për rigjykim nuk kanë ndikim në marrjen e formës së prerë të aktgjykimit të Gjykatës Supreme. Në fakt, ato demonstrojnë të kundërtën, se një rigjykim është i

⁹ Konfirmuar nga dëshmia e tij, 16 shtator 2013;

¹⁰ Shih faqe 5, dëshmia **B. M.**, më datë 12 shtator 2013;

mundshëm vetëm pasi që një gjykatë përmbyllë një shqyrtim të mëparshëm nëpërmjet vendimit të formës së prerë. Kërkesat për rigjykim nuk ndalojnë ekzekutimin e aktgjykimit të Gjykatës Supreme. Ligji mbi Procedurën Civile dhe Ligji mbi Procedurën Kontestimore janë relevante tani.

Ligji mbi Kadastrin nr. 2003/25, i cili ishte në fuqi deri në gusht 2011, në veçanti neni 16. 5 i Ligjit nr. 2003/25 zbatohet në situatën aktuale, ekzistonte nevoja për *amalgamim* të parcelave të ndara duke qenë se vendimi i Gjykatës Supreme kërkoi që toka në fjalë të kthehej në gjendje të saj të mëparshme. Pavarësisht dështimit të vazhdueshëm për t'iu referuar paragrafit (b) të këtij neni nga ana e avokatit mbrojtës, paragraph (b) *ç'është e vërteta, ekziston* dhe thotë se mund të regjistrohet amalgamimi nëse është vetëm në njërën nga parcelat e tokës në fjalë është vënë hipoteke.¹¹ Prandaj, ekzistimi i një hipoteke nuk solli pengesë ligjore për të ekzekutuar vendimin në fjalë.

Nga gushti 2011 është zbatuar neni 14 i Ligjit të Kadastrit nr. 04/L-013. Sipas këtij ligji, lejohet amalgamimi ku ekziston një hipoteke (gjë që është rasti këtu) pasi që është dhënë pëlqimi i hipotekuesit apo i poseduesve të tjerë të të drejtave pronësore për një rend të ri prioritetesh në parcelën e re të amalgamuar. Vendimi i Gjykatës Supreme është ekzekutuar rreth 4 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji të ri. Është zbuluar se borgjet janë paguar dhe se hipoteka është pezulluar.

Në pajtim me nenin 62 të ligjit mbi vetë-qeverisje lokale, çdo drejtori komunale menaxhohet nga drejtori dhe në pajtim me nenin 9 të “vendimit mbi strukturën e brendshme dhe caktimit të posteve stafit në organe komunale civile të shërbimit”, adoptuar nga kuvendi komunal në Prizren në seancën e mbajtur më 22 prill 2004¹² “puna e Drejtorisë Komunale menaxhohet nga Drejtori i Drejtorisë ...”. Më tutje, neni 62 i Ligjit mbi vetë-qeverisjen lokale thekson se drejtorët menaxhojnë drejtoritë e tyre në pajtim me strategjitë strategjike dhe politike të krytarit të komunës dhe në pajtim me ligjet dhe rregulloret komunale në fuqi.

Neni 8.7 i Ligjit nr. 2003/25 mbi kadastrin, më datë 04/12/2003 përcakton se ndryshimet relevante në kadastrë do të regjistrohen sapo të shqyrtohet dhe të aprovohet dokumentacioni kërkuar, në këtë rast, aktgjykimi i Gjykatës Supreme. Ai e ka bërë të kundërtën duke vendosur “ndalesë” për të trajtuar pronës pasi që është pranuar aktgjykimi i Gjykatës Supreme. **Dëshmitari B.B.** qartë ka deklaruar në dëshminë e tij se ai kurrë nuk i ka parë memorandumet 621/08 apo 622/08 e as aktgjykimin e Gjykatës Supreme. I vetmi arsyetim i tij për këtë gjë ishte se K.U. i pranoi dokumentet, por nuk ia drejtoi atij për vlerësim.

¹¹ Shih letrën nga banka, më datë 23.11.2011

¹² Shih faqe 000883 të dosjes së lëndës;

Sipas nenit 62.2 të Ligjit Nr. 03/L-040 mbi vetë-qeverisje lokale më datë 20/02/2008 (LVQL) pasi që Kryetari i Komunës R.M. kishte fuqinë për të punësuar dhe larguar nga puna K.U. si drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër dhe poashtu kishte të drejtë t'i japë udhëzime lidhur me ekzekutimin e detyrave të Drejtorisë, neni 13, LVQL. Shkeljet e **M.** përfshijnë nenin 58, LVQL, që ka të bëjë me “përgjegjësitë e kryetarit të komunës” dhe në veçanti, pika a) dhe c) e kësaj dispozite që thotë se kryetari i komunës “vepron në emër të komunës” dhe se duke vepruar në cilësinë e tij zyrtare, ai “ushtron të gjitha kompetencat të cilat nuk i janë caktuar në mënyrë të qartë kuvendit komunal apo komiteteve të tij”.

E.M. (dëshmi më datë 12 shtator 2013) avokati publik i komunës së Prizrenit nga 1 korrik 2001 deri më 30 shtator 2008 nxorri parashtresën Nr. 622/08,¹³ dhe letrën Nr. 621/08 më datë 01/07/2008¹⁴. Që të dy, parashtresa dhe letra janë regjistruar në mënyrë të rregullt në zyrën e protokollit.¹⁵ Çdo argument se dokumentet nuk kanë arritur në destinacionin e tyre nuk ka vlerë. **B.B.**, bashkëpunëtor profesional në Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër, sqaroi gjatë dëshmisë së tij më 12 shtator 2013, se *çdo* dokument i dërguar në Drejtori fillimisht shkon në Zyrën e Protokollit, regjistrohet me numër të protokollit dhe pastaj shkon te drejtori i Drejtorisë, i cili pastaj “filtron” dokumentet dhe i dërgon te zyra/ personi kompetent për shqyrtim/ekzekutim; **A.H.** (dëshmia 12 shtator 2013), avokati komunal publik nga 15 shtatori 2008 deri në maj 2011, nënshkroi dhe dërgoi një letër zyrtare përkujtuese Drejtorisë së Gjeodezisë dhe Kadastrit më 12.11.2008.¹⁶ është kërkuar nga Drejtoria që të sjellë informata lidhur me ekzekutimin e aktgjykimit të Gjykatës Supreme. Përkujtimi është regjistruar zyrtarisht në Zyrën e Protokollit.¹⁷ Asnjë veprim nuk është ndërmarrë. **B.M.** (dëshmi 12 shtator 2013), avokati publik (nga 1 nëntor 2011) deri më 16 nëntor 2011 poashtu dërgoi kërkesë në Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër¹⁸ duke kërkuar ekzekutimin e aktgjykimit të Gjykatës Supreme. Kërkesa është regjistruar në Zyrën e Protokollit të Drejtorisë.¹⁹

Këto deklaratatë të dëshmitarëve demonstrojnë se çështja është trajtuar me avokatë publikë, por pastaj janë penguar nga **M.** dhe **U.**

Në gjykatë **U.** pretendoi se ai kurrë nuk pranoi memorandumet. Është e qartë se kjo nuk është e vërtetë dhe plotësisht në kundërtë me deklaratat e tij të mëparshme. Gjykata i fali më shumë besim deklaratës së tij të mëparshme sepse konfirmohet me mos ekzekutimin e aktgjykimit. Pohimi i **U.** se aktgjykimi ka qenë i pazbatueshëm për shkak

¹³ Shih faqe 1202-1203 (verzioni anglisht) dhe faqe nr1203-1204 (verzioni shqip) të dosjes së lëndës;

¹⁴ Shih faqe 1200 (verzioni anglisht) dhe faqe 1201 (verzióni shqip) të dosjes së lëndës;

¹⁵ Numri relevant I protokollit është 027 Nr. 1949/B, 01.07.08 ;

¹⁶ Shih faqe nr. 1213 (verzióni anglisht) dhe faqe nr. 1214(verzióni shqip) i dosjes së lëndës;

¹⁷ Numri i protokollit 029 nr.3483/Z, 13.11.08;

¹⁸ Shih faqe 1253 (verzióni anglisht) dhe faqe 1254 (verzióni shqip) i dosjes së lëndës;

¹⁹ Vula në pjesën e lart të djalhtë me numrin 07-029-12903/Z, 16.11.2011;

se ekzistimit të hipotekave është i bërë qëllimisht. Kjo çështje nuk ishte në kokën e tij në kohën e kryerjes së veprave penale – ai asnjëherë nuk shkoi te avokatët për të diskutuar ndonjë çështje të hipotekës dhe asnjëherë nuk ka dhënë parashtrësata apo aktgjykimin avokatit në zyrën kadastrale. Kjo gjë është konfirmuar nga **B.B.**

Të pandehurit e dinin se M.K., atëherë zëvendës kryetari komune dhe drejtor i Drejtorisë së Administratës, ishte në posedim të një parcele tokë dhe poashtu e dinte se ai po ndërtonte në tokë. Qëllimi prapa moszbatimit të aktgjykimit të prerë ishte përtej çdo dyshimi, për të sjellur përfitim M.K. dhe prandaj edhe poseduesve të tjerë të tokës. Qëllimi indirekt apo eventual për të shkaktuar dëm komunës, të pandehurit e dinin se komuna po vuante si rezultat i mosveprimit të tyre, por prapsepër vazhduan të injorojnë ligjin.

Argumentimi se aktgjykimi nuk mund të ekzekutohet për shkak se nuk ishte i formës së prerë për shkak të ekzistimit të rihapjes së procedurës, është i pasaktë. (Është e nevojshme të thuhet se argumentet e tilla janë bërë gjatë fazës për deklarim të fajësisë apo gjatë shqyrtimit kryesor dhe i vetmi qëllim ishte të mbulohej dashja kriminale).

Gjetjet faktike AKUZA II

- Më 13/05/2009 Qendra Edukative “Gulistan” dorëzoi në Komunën e Prizrenit kërkesën Nr. 09/05/051302 për dhënien e 5-6 ha tokë publike për ndërtim të ndërtesës së shkollës me infrastrukturën bashkangjitur. Aplikuesi deshi të ketë tokën për 99 vjetë dhe të lirohej nga çdo detyrë e pagesës për shfrytëzim të tokës, në anën tjetër, Qendra Edukative propozoi përfitime për Komunën e Prizrenit. Më 18/06/2009, Kuvendi Komunal i Prizrenit mbajti takimin gjatë së cilit është diskutuar propozimi i Qendrës Edukative “Gulistan”. Kuvendi Komunal votoi mbi autorizimin e përgjithshëm që organet kompetente të japin tokë komune pa specifikuar vendin në mënyrë që kjo e fundit të mund të gjej pastaj parcelën e tokës për t’i dhënë me qira “Gulistanit”. Si rezultat i këtij vendimi (Nr 01/011-4325), 6 ha tokë komune është dhënë për 99 vjetë pa kompensim dhe zyrtarët e komunës janë autorizuar të gjejnë lokacionin e duhur. Më datën e njëjtë, **N.K.** nxorri vendimin tjetër, atë nr 01/011-4539 duke u dhënë “Gulistanit” tokën bujqësore me sipërfaqe prej 5-6 ha që gjendet në rrugën lokale për në fshatin Nashec për shfrytëzim të përhershëm pa kompensim për ndërtim të kompleksit shkollor përfshirë edhe infrastrukturën shtesë. Vendimi i njëjtë autorizoi R.M. të marrë vendimin mbi bartjen e së drejtës për të përdorur këtë tokë pa kompensim, kohëzgjatjen e shfrytëzimit të tokës dhe detale të tjera. Nuk ishte e mundshme të jepej parcela e tokës e specifikuar në vendimin e lartpërmendur Nr. 01/011-4539 në rajonin e fshatit N. për shkak të protestave të fshatarëve të vendit. Si pasojë, ishte e nevojshme të gjindet një lokacion tjetër i duhur për investimin e planifikuar të “Gulistanit”. Lokacioni i ri është gjetur në parcelën e tokës Nr. 800 në sipërfaqe

prej 474,434 m² në “Boka Boka”, lista poseduese Nr. 553 CZ Korisha. Kjo tokë nuk ishte pronë e komunës së Prizrenit, por ishte regjistruar në emër të organizatës punuese të pylltarisë ‘SHARRI’ – OPB Ekonomia e Pyjeve. Si e tillë, ishte nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe çdo bartje e të drejtave për të përdorur këtë tokë nga komuna varej nga vendimi pozitiv AKP-së. Pavarësisht se toka në lokacionin e ri në “Boka-Boka” ishte nën menaxhimin e AKP-së, më 24/11/2010 R.M. nxorri vendimin Nr. 01-370 nëpërmjet së cilës komuna e Prizrenit mori në posedim një pjesë të parcelës së tokës së lartpërmendur për qëllim të investimit të planifikuar. **Më datë të njëjtë**, pas këtij vendimi, M.K., drejtori i Drejtorisë së Administratës/Zyra për Pronë dhe Çështje Ligjore të komunës së Prizrenit, dorëzoi kërkesën Nr. 03/3 te Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, ku theksoi se ndryshime të menjëhershme do të bëhen në të dhënat kadastrale lidhur me parcelën e tokës nr. 800 në pajtim me vendimin e lartpërmendur të kryetarit të komunës së Prizrenit. Ky dokument është nënshkruar nga **G.S.**, koordinator i Sektorit për Pronë – Çështje Ligjore brenda Drejtorisë së Administratës, i cili tha në dëshminë e tij se M.K. i tha të nënshkruajë dokumentin. Më datën e njëjtë, duke vepruar ndaj kësaj kërkesë, A.A., ushtrues detyre drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër në komunën e Prizrenit, nëpërmjet vendimit Nr. 07-025-6976/Z aprovoi bartjen e pronësisë nga Organizata Punuese e Pylltarisë ‘SHARRI’ – OPB Ekonomia e Pyjeve në komunën e Prizrenit. **B.B.**, bashkëpunëtor profesional, përpiloi vendimin për aprovim të bartjes së pronësisë në përgjigje ndaj kërkesës së drejtorit të tij, A.A.. Më 24 nëntor 2010 në 12:08, janë bërë ndryshimet në shënimet kadastrale duke dëshmuar se komuna e Prizrenit është pronar i parcelës së tokës në fjalë.

- Me të marrë në posedim parcelën e tokës Nr. 800 në “Boka Boka”, R.M. nënshkroi kontratën nr. 01/17 (regjistruar më 11/02/2011) mbi kushtet për shfrytëzim të pronës së patundshme me “Gulistan”, përfaqësuar nga drejtori **T.S.** Kontrata thotë se është e bazuar në ligjin nr. 03/L-226 mbi dhënien për shfrytëzim dhe shkëmbim të pronës së paluajtshme (LAP) dhe vendimi nr. 01/011-4539 (nxjerrë nga kryetari i Kuvendit Komunal, duke dhënë një parcelë në rrugën për në fshatin Nashec). Parcela e tokës nr. 800/2 është dhënë në shfrytëzim “Gulistanit” për një periudhë prej 40 vjetëve. “Gulistani” është liruar nga çdo pagesë për shfrytëzim të tokës me përjashtim të pagesës për ndërrim të “formës” së tokës nga ajo bujqësore në atë ndërtimore (neni 12). Më 11/02/2011, M.K. dorëzoi në Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër të komunës së Prizrenit kërkesën nr. 03/3 për të regjistruar të drejtën e “Gulistanit” për të përdorur tokën e dhënë për 40 vjetë. Ky dokument është nënshkruar në emër të M.K. dhe sipas udhëzimeve të **G.S.**

Pavarësisht faktit se iniciativa për këtë kontratë rezultoi nga vendimi nr. 01/011-4539 i Kuvendit Komunal i Prizrenit, nuk është respektuar ngase një parcelë tjetër e tokës i

është dhënë “Gulistanit”. Kuvendi Komunal as nuk është informuar mbi ndryshimin e lokacionit apo nënshkrimin e kontratës së lartpërmendur me “Gulistanin” e as publiku.

Përfiti i marrë nëpërmjet vlerës së qirasë nëpërmjet nënshkrimit të kontratës me “Gulistanin” për katërdhjetë vjetë, është 20.120 Euro. Ky përfitim është llogaritur sipas vlerës me qira të tokës, vlerësuar nga eksperti A.Sh.në ekspertizën e urdhëruar nga gjyqtari nga EULEX-i Anne Marie Meister, ku eksperti vlerësoi vlerën e qirasë së parcelës 800/2 për 503 EURO në vit.

Gjetjet faktike Akuza III

Më 2010 “Kamila”, me seli në Gjakovë i është drejtuar komunës së Prizrenit për t’i ndihmuar në kërkimin e një pjese adekuate të tokës për të ndërtuar fabrikën e çokollatave. Gjatë një takimi të mbajtur më 04/03/2010, zyrtarët e komunës i premtuan “Kamilës” se ata do të gjejnë një lokacion të duhur për investimin e planifikuar. Më 10/05/2010, shefi ekzekutiv i “Kamilës” E.S. dërgoi një kërkesë kryetarit të komunës së Prizrenit dhe Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor për dhënien e 2 ha të komunës në lokacionin e Parkut të Biznesit përball Hotel OK përgjatë rrugës Prizren-Prishtinë.²⁰

- Më 15/12/2010, R.M. duke vepruar në cilësinë e kryetarit të komunës së Prizrenit, nënshkroi me E.S. Marrëveshjen e Partneritetit Publiko-Privat dhe Koncesionet mbi Shfrytëzimin e Pronës së Paluajtshme të komunës së Prizrenit më datë 15/12/2010²¹. Sipas kësaj marrëveshje, parcela të ndryshme të tokës, duke arritur sipërfaqen e përgjithshme prej 13.935 m² në Prizren, lista poseduese nr. 593 CZ Lubizhde, përfshirë në planin ekzistues rregullativ urban, ëshët dashur t’i jepeshin “Kamilës” për shfrytëzim për një periudhë prej 10 vjetëve me mundësi zgjatjeje për edhe dhjetë vjetë të tjera. Në shkëmbim, “Kamila” kishte për obligim të shfrytëzojë tokën e dhënë për ndërtim të fabrikës së çokollatave në vlerë prej 2 milionë Euro, të paguajë të gjitha taksat komunale për leje të ndërtimit, të mbulojë shpenzimet e tjera dhe poashtu të punësojë një numër punëtorësh. Ligji që qeverisë marrëveshjen, palët cituan të jetë Ligji mbi Partneritetin Publiko-Privat dhe Koncesione në Infrastrukturë dhe Procedurat për marrje nr. 03/L-090 i 25/06/2009 (LPPP).
- Më 03/03/2011 “Kamila” kreu pagesat fillestare të kërkuara (taksat) në llogarinë e komunës së Prizrenit.

²⁰ Shih faqe 2005 (verzioni anglisht) të dosjes së lëndës;

²¹ Shih faqe 2007 (verzioni anglisht) të dosjes së lëndës;

- Ligji mbi dhënien dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ishte në fuqi në kohën në fjalë. Kur R.M. nënshkroi kontratën me “Kamilën”, 15 dhjetor 2010, nuk kishte aprovim të Kuvendit Komunal për dhënie të parcelës së tokës në fjalë në Lubizhde, siç kërkohet me LAP.
- Punët përgatitore për ndërtimin e fabrikës së çokollatave së shpejti janë ndërprerë ngase fshatarët në Lubizhde pretendonin pronësi mbi tokën e dhënë. Për pasojë, S.P. dhe R.M. vendosën që në vend të kësaj, t’i japin ‘Kamilës’ parcelën e tokës nr. 688/2, në sipërfaqe prej 20.000 m² në "Boka Boka" në Prizren në vlerë prej 40.000 EUR, lista poseduese nr. 257 në CZ Lutogllave. Ky rajon nuk ka qenë i përfshirë në asnjë plan rregullativ urban dhe që të dy, **M.** dhe **P.** ishin në dijeni për këtë.
- Më 4 mars 2011, S.P., drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor nxorri vendimin nr. 04-351-2051 duke lejuar ndërtimin e fabrikës së çokollatave në vlerë prej 1.294.690,50 Euro në parcelën e tokës në Llutogllave.²² Në atë kohë, parcela e tokës në Llutogllave nuk ishte dhënë nga Kuvendi Komunal dhe në fakt, asnjë kontratë nuk është nënshkruar në mes askujt nga komuna dhe “Kamila”, dhënien e tokës për shfrytëzim.
- Një muaj pas dhënies së lejes për ndërtim në parcelën e tokës në Llutogllave nga **P.**, kontratat për lejim të shfrytëzimit të tokës (kontratat për shfrytëzim të tokës komunale dhe caktim të çmimit të qirasë për ndërtim të strukturës) është nënshkruar mes **P.** dhe S.²³ Akoma nuk është dhënë asnjë aprovim nga Kuvendi Komunal. Kontratat lejuan “Kamilën” të shfrytëzojë parcelën e tokës nr. 688/2, parcelë toke krejtësisht tjetër nga ajo në kontratën fillestare të datës 15/12/2010.
- Në kohën kur **P.** nënshkroi kontratën me Kamilën duke dhënë kështu pronën e komunës, toka në fjalë në Llutogllave nuk ishte e përfshirë në asnjë Plan Rregullativ Urban.

Më 15/04/2011, kontrata për dhënie të tokës komunale është nënshkruar nga S.P. dhe “Kamila”. Kontrata lejoi “Kamilan” të shfrytëzojë parcelën e tokës nr. 688/2 dhe e liroi këtë të fundit nga çdo pagesë për shfrytëzim të parcelës së tokës, me përjashtim të pagesës së taksave të kërkuara komunale.

²² Shih faqe 20136 (verzioni anglisht) të dosjes së lëndës;

²³ Shih faqe 2040 (verzioni anglisht) të dosjes së lëndës; më 15/04/2011 kontrata nr. 04-353 për shfrytëzim të tokës komunale dhe caktim të çmimit të qirasë për ndërtim të strukturës – fabrika e çokollatave është nënshkruar mes **S.P.**, që përfaqëson komunën e Prizrenit dhe **E.S.** që përfaqëson “Kamilan”

Përfitimi me vlerë të qirasë nëpërmjet nënshkrimit të kontratës me “Kamilën” për 10 vjetë është 4500 Euro. Ky përfitim është vlerësuar në pajtim me vlerën e qirasë së tokës nga eksperti A.Sh. në ekspertizën e urdhëruar nga Gjyqtarja e EULEX-it Anne Marie Jaggermeister, ku eksperti ka vlerësuar vlerën e qirasë së parcelës 688/2 në shumën prej 450 Euro në vit.

Gjetjet faktike Akuza 4

- Në periudhën para 02/08/2011, individë privatë kanë ushtruar padi civile në gjykata në Prizren për kthim të tokës. Në këto raste, para se të nxjerrej aktgjykimi është dashur të dëgjohen ekspert të gjeodezisë për të dhënë mendimin e tyre profesionalë lidhur me të dhënat kadastrale, p.sh. historia e pronave, statusi i tyre ligjor, shënimet dhe ndryshimet në të dhënat kadastrale disa padi të tilla janë ngritur ndaj komunës së Prizrenit, e cila akoma është në posedim të një numër të parcelave të tokës për të cilat invidiët në fjalë pretendojnë se janë të tyre.
- Gjykata besoi se ishte e udhës të ftojë ekspertë të gjeodezisë të punësuar në komunën e Prizrenit në vend se të ftojë ekspertë privatë për shkak se të parët kishin qasje të pakufizuar dhe të lehtë në të dhënat kadastrale ndërsa ekspertët privatë hasnin në pengesa. Kjo gjë është thënë në letrën e gjyqtarit V.T.C.Nr. 583/11 më datë 01/09/2011²⁴si dhe se mendimi i të dytëve nuk ishte aq preciz dhe i detalizuar sikurse mendimi i ekspertëve komunalë të gjeodezisë.

Y.H., kryetari i atëhershëm i Gjykatës së Qarkut në Prizren dëshmoi se është informuar nga Gjyqtari V.T. lidhur me përfundimin për të ndaluar ekspertët e gjeodezisë nga ardhja në gjykatë.²⁵ Dëshmitari, i cili poashtu është kryetari aktual i Gjykatës së Qarkut në Prizren, deklaroi se ai ishte në dijeni mbi ekzistimin e ekspertëve privatë të licensuar të gjeodezisë. Mirëpo, ai theksoi se “gjyqtari kontaktoi ekspertët privatë të gjeodezisë dhe këta ekspertë privatë i kanë thënë se nuk kanë qasje në informata”²⁶. dëshmitari poashtu i është referuar të drejtës së gjykatës për të përdorur si “individ që ka kualifikime të nevojshme”²⁷.

Gjatë shqyrtimit kryesor është kuptuar se janë vetëm rreth 5-6 gjeodetë të licensuar në gjithë rajonin e Prizrenit²⁸ dhe këta nuk ia dilnin gjithnjë të përgjigjeshin në ftesa. Më tutje, kryerja e detyrave të tyre varej nga ekspertët e komunës. Edhe **B.S.** kofnirmoi se të angazhuar nga gjykatë, ekspertët privatë nuk mund të procedonin pa i pasur informatat të cilat ishin në posedim të vetëm të Drejtorisë së Gjeodezisë dhe Kadastrit. Ai e përshkroi

²⁴ Shih faqe 2104 (verzioni anglisht) të dosjes së lëndës;

²⁵ Dëshmia, 10 tetor 2013.

²⁶ Shih faqe 10, dëshmia, **I.H.**, 10 tetor 2013;

²⁷ Shih faqe 7, dëshmia, **Y.H.**, 10 tetor 2013;

²⁸ Shih faqe 4, dëshmia, **B.S.**12 nëntor 2013; faqe 7, dëshmia, **K.G.**, 12 nëntor 2013;

procedurës që një ekspert privat duhet ndjekur: ata (ekspertët privatë) “sjellin një kërkesë zyrtare dhe ne marrin informatat dhe të dhëna që kanë për obligim të sjellin ...”²⁹

K.G., ekspert privat i gjeodezisë po ashtu, ka konfirmuar se nuk ka pasur qasje të lehtë në të dhënat e kadastrit.

Si rezultat, duket se drejtorati i gjeodezisë dhe kadastrit angazhohet në procedurë gjyqësore, edhe atëherë kur caktohet një ekspert privat.

- Më tej, vetë gjeodetët komunal kanë dëshmuar se puna e drejtoratit nuk ka pësuar si rezultat i mungesës së tyre. Është e qartë se ata kanë ndjekur një lloj procedure për të siguruar rrjedhën e punës. **L.R.**, ka qenë e qartë kur ka thënë se sa herë ka shkuar në gjykatë, ajo ka pasur dikë që e ka zëvendësuar në komunë.³⁰ **R. S.**, një ekspert tjetër komunal, po ashtu ka konfirmuar se puna në Komunë nuk ka pësuar në rastet kur ekspertët kanë qenë në gjykatë.³¹
- Çështja e pjesëmarrjes së ekspertëve komunal të gjeodezisë në seanca dëgjimore në gjykatë ka qenë temë diskutimi brenda Bordit të Drejtorëve të Komunës së Prizrenit. Gjatë takimit të datës 02/08/2011 M.K., Drejtor i Drejtoratit të Administratës/Zyra për Prona dhe Çështje Ligjore në Komunën e Prizrenit, ka parashtruar me gojë propozimin që të lëshohet një vendim sipas të cilit do të ndalohet një pjesëmarrje e tillë. Në agjendën e takimit, dokumenti Nr. 01/06-8121 i datës 02/08/2011³², nuk është paraparë të diskutohet mbi një pikë të tillë që do të thotë se propozimi nuk i është parashtruar zyrtarisht Bordit por është paraqitur *ad hoc* nga ana e M.K., gjatë diskutimit mbi pikën 10 të Agjendës³³. Për të arsyetuar propozimin e tij M.K. thjesht ka deklaruar se ‘punëtorët e komunës nuk mund të jenë ekspertë në gjykatë’ dhe se ‘komunat e tjera e kanë zbatuar këtë ndalesë po ashtu’.
- Duke ndjekur këtë propozim, Kryetari i Komunës së Prizrenit, R.M., ka lëshuar një Përfundim sipas të cilit ai ka ndaluar ekspertët e gjeodezisë të punësuar në Komunën e Prizrenit të marrin pjesë në seanca gjyqësore dhe të japin mendimet e tyre prej ekspertësh në lëndë civile që shqyrtoheshin nga gjykata.³⁴ Të njëjtën ditë, A.T., Drejtor i Drejtoratit të Gjeodezisë dhe Kadastrit në Komunën e Prizrenit, ka kumtuar përfundimin Nr. 01/06-8121 ekspertëce kadastral duke u thënë se nga

²⁹ Shih faqe 6, dëshmia, **B.S.**12 nëntor 2013;

³⁰ Shih faqe 25, 28, dëshmia e **L.R.**, 10 tetor 2013;

³¹ Shih faqe 36, dëshmia e **R.S.**, 10 tetor 2013;

³² Shih faqe 2071 (verzioni anglisht) në dosjen e lëndës;

³³ Shih faqe 2082 (verzioni anglisht) në dosjen e lëndës;

³⁴ Shih faqe 2100 (verzioni anglisht) në dosjen e lëndës;

ai moment deri në një njoftim tjetër asnjë ekspert i nuk i lejohet përgjigja në ftesë të gjykatës.

L.R. gjatë dëshmisë së saj ka konfirmuar deklaratën e saj dhënë prokurorit ku ka thënë se A.T. i ka dhënë një kopje të përfundimit **B.B.** i cili e ka shpërndarë.³⁵ **R.S.** po ashtu ka konfirmuar se **A.T.** ka informuar ata lidhur me përfundimin e lëshuar nga Kryetari i Komunës.³⁶ Të dy dëshmitarët kanë dëshmuar se ata nuk kishin marrë pjesë në disa seanca gjyqësore si rezultat i ndalesës. Të dy e kanë ditur se ka qenë obligim i tyre t'i përgjigjen thirrjeve të gjykatës, por nuk e kanë bërë këtë për shkak të ndalesës. **L.R.** ka deklaruar: "Jam në dijeni [për obligimin t'i përgjigjem], por që nga vendimi, jam punëtore e Komunës, më është dashur t'i bindem përfundimit" duke shtuar se është brengosur për vendin e saj të punës.³⁷

I.K. (dëshmitar i propozuar nga mbrojtja), Shef i Drejtoratit Ligjor në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, ka dëshmuar se Ligji mbi Gjykatat parasheh që çdokush të përgjigjet në thirrje të gjykatës.³⁸ Ai nuk ka identifikuar ndonjë përjashtim.

- Si rrjedhojë, nuk janë mbajtur disa seanca gjyqësore dhe këto lëndë kishin ngecur. Është konfirmuar se prej datës 06/09/2011 ekspertët nuk janë paraqitur në ndonjë seancë gjyqësore për të cilat ishin ftuar nga gjykata së paku në 7 raste; d.m.th. C 244/11, C 583/11, C 539/11, C 526/11, C 727/06, C 388/11, C 872/08.

Y.H., kryetar i Gjykatës Themelore, ka shpjeguar efektin e përfundimit. Ai ka deklaruar se përfundimi ka penguar punën e saj. Ai ka deklaruar: "Shumë lëndë kanë mbetur të paprocesuara. Ka pasur lëndë përfshirë masat e përkohshme...."³⁹ Puna e Gjykatës është çrregulluar në atë masë për shkak të ndalesës sa që Kryetari i Gjykatës për këtë ka informuar të dy të pandehurit, R.M. dhe A.T.⁴⁰

Kryetari i ish-Gjykatës Komunale në Prizren, **H.D.,** në deklaratën e tij dhënë prokurorit dhe lexuar në gjykatë më datën 12 nëntor 2013, ka hasur në problem të ngjashme. Ai ka deklaruar se, "Asnjë nga kontestet pronësore nuk mund të zgjidhen pa praninë e [ekspertëve][komunal] të gjeodezisë...", dhe më tej, "ne tani nuk mund të planifikojmë seanca të reja gjyqësore meqë nuk e dimë çfarë të bëjmë me palët në kontest."⁴¹

³⁵ Shih faqe 27, dëshmia e L.R., 10 tetor 2013;

³⁶ Shih faqe 35, dëshmia e R.S., 10 tetor 2013;

³⁷ Shih faqe 27, dëshmia e L.R., 10 tetor 2013;

³⁸ Shih faqe 21, dëshmia e I.K., 12 nëntor 2013;

³⁹ Shih faqe 6, dëshmia e Y.H., 10 tetor 2013;

⁴⁰ Shih faqe 6, dëshmia e Y.H., 10 tetor 2013;

⁴¹ Shih faqe 721, deklaratë e H.D., 12 dhjetor 2011;

- më 07/09/2011, Gjykata e Qarkut në Prizren i ka dërguar Kryetarit të Komunës së Prizrenit një letër me Nr. 1/2011-65, duke kërkuar tërheqjen e Përfundimit.⁴² Në letër është specifikuar që veprimi i Kryetarit të Komunës së Prizrenit është në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit mbi Gjykatat e Rregullta në Kosovë të datës 26/04/1978 i cili i jep pushtet gjykatave të kërkojnë ndihmë nga entitetet publike sipas nevojës dhe autoritetet e tilla janë të obliguara t'i binden kërkesës dhe thirrjes së gjykatës.
- Një letër me përmbajtje të njëjtë po ashtu i është dërguar edhe Drejtorit të Gjeodezisë dhe Kadastrit, A.T.

Y.H., ka dëshmuar në gjykatë se në mbrëmjen e ditës së njëjtë (07 shtator 2011) ka pasur një bisedë telefonike me R.M. Dëshmitari është munduar të zgjidhë problemin duke kërkuar nga Kryetari i Komunës të pushojë ndalesën.⁴³ Në këtë deklaratë dhënë prokurorit dhe të cilën e ka konfirmuar në gjykatë, ai ka thënë se gjatë bisedës ai i ka shpjeguar Kryetarit të Komunës se përmes letrës ai është nxitur të pushojë ndalesën, këshilluar se është duke shkelur ligjin dhe është informuar se se paditësit civil janë duke pësuar si rezultat i Përfundimit. R.M. është përgjigjur duke thënë se përkundër gjithë kësaj ai nuk do të ndryshojë qëndrimin e tij dhe ekspertët e gjeodezisë nuk do të marrin pjesë në seanca gjyqësore sepse ai dëshironte të ndalonte kontestet gjyqësore në të cilat toka komunale mund t'i jepet' individëve privat.

Më datë 12/09/2012 **Y.H.** po ashtu ka thirrur A.T. dhe gjatë bisedës telefonike i pandehuri i ka thënë atij se, “ai nuk ka mundësi të bëjë asgjë lidhur me korrigjimin e këtij konkluzioni”. Pastaj, edhe në një përpjekje tjetër të zgjidhet kjo çështje, më datë 13/09/2012 **Y.H.** ka ftuar A.T. dhe Zëvendës Kryetarin e Komunës së Prizrenit, **R.R.** të gjejë një zgjidhje. Gjatë kësaj kohe **R.R.** ka thirrur R.M. në telefon. Në këtë kohë, ky i fundit, R.M., ka përsëritur se nuk do të tërheqë Konkluzionin.⁴⁴

- është përfshirë prokurori i EULEX-it. Më 07/12/2011 prokurori i EULEX-it ka parashtruar pranë Gjykatës Supreme të Kosovës kërkesë për të inicuar konflikt administrativ kundër Kryetarit të Komunës së Prizrenit, R.M., duke pretenduar se Konkluzioni ka qenë i kundërligjshëm dhe si i tillë duhet anuluar. Pasi zyrtarët kanë pranuar një kopje të kësaj kërkesë njëri nga zyrtarët, konkretisht M.K., më datë 6 janar 2012, i ka dërguar letër Kryetarit të Gjykatës së Qarkut **Y.H.** duke e ftuar në Komunë. Në letër **K.** ka deklaruar se ai po ashtu ka dashur që kryetari të nënshkruajë një memorandum mirëkuptimi të përpiluar bashkërisht “mbi ofrimin e mjetit ligjor nga ekspertët e Gjeodezisë dhe Kadastrit të Komunës së Prizrenit,

⁴² Shih faqe 2159 (verzióni anglisht) në dosjen e lëndës;

⁴³ Shih faqe 5, dëshmia e Y.H., 10 tetor 2013;

⁴⁴ Shih faqe 5, dëshmia e Y.H., 10 tetor 2013;

përfshirë kushtet e bashkëpunimit, kriteret dhe kapacitetet reale të këtij mjeti”⁴⁵. Në këtë letër është thënë se nënshkrimi i këtij memorandum është parakusht për tërheqjen e Konkluzionit.

- Pas inicimit të konfliktit administrativ, më 26/01/2012, përmes vendimit të tij Nr. 01/06 R.M. ka tërhequr Konkluzionin.⁴⁶

5. Gjetjet ligjore, cilësimi i veprimeve të kryera dhe të pandehurit

a. Akuza I – Aktgjykimi i Gjykatës Supreme

Lidhur me aktin e parë të Aktakuzës ku Aktgjykimi i Gjykatës Supreme rev. nr. 209/2005, i datës 25 maj 2006 ka pasur vonesa në zbatim, është qëndrim i vendosur i Trupit gjykues se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme duhet të ekzekutohet menjëherë si autoritet më i lartë dhe i fundit në sistemin gjyqësor në Kosovë, që do të thotë se aktgjykimi i lartpërmendur është res judicata dhe si i tillë është vendim i formës së prerë.

Aktgjykimi i Gjykatës Supreme është kontestuar gjatë shqyrtimit kryesor nga disa palë të avokatit mbrojtës duke thënë se ka pengesa në ekzekutimin e atij Aktgjykimi meqë kishte hipotekë mbi njërin nga tre parcelat, prandaj tre parcelat nuk mund të ri-bashkohen në një, përderisa hipoteka është detyruese. Trupi gjykues është në dijeni se Gjykata Supreme është autoriteti më i lartë në gjykimin e çështjes, është e qartë për këtë Trup gjykues se Aktgjykimi nuk mund të kontestohet më tutje në një procedure ankimore, prandaj aktgjykimi është i ekzekutueshëm.

Lidhur me këtë nevojitet elaborim i akteve ligjore. Ligji mbi Kadastrin nr. 2003/25, që ka qenë i aplikueshëm deri në gusht 2011 specifikisht neni 16. 5 i Ligjit nr. 2003/25 është i aplikueshëm në situatën aktuale që qartëson procesin e **B.it** të parcelave në një dhe lidhur me këtë ligji parasheh;

16.5. Shkrimi mund të regjistrohet vetëm:

- a. Nëse parcelat tokësore në fjalë janë të lira nga hipotekat dhe garancitë tjera ose*
- b. Nëse vetëm njëra prej parcelave tokësore në fjalë është nën hipotekë ose nën garanci ose*
- c. Nëse hipotekuesit në fjalë apo tjerë posedues të të drejtave pronësore kanë dhënë miratimin e tyre për një rend të ri të prioriteteve në parcelën e re tokësore.*

Nga gushti 2011, Ligji mbi Kadastrin nr. 04/L-013 ka qenë i aplikueshëm sa i përket kësaj neni 14 i Ligjit mbi Kadastrin është i aplikueshëm i cili parasheh;

⁴⁵ Shih faqe 2211 (verzioni anglisht) në dosjen e lëndës;

⁴⁶ Shih faqe 223 (verzioni anglisht) në dosjen e lëndës;

4. *B.i mund të regjistrohet vetëm:*

4.1. *nëse parcelat në fjalë janë të lira nga hipotekat dhe ngarkesat tjera, ose*

4.2. *nëse kreditori apo tjerë posedues të të drejtave pronësore kanë dhënë pëlqimin e tyre për një rend të ri të prioriteteve në parcelën e re të bashkuar.*

Sipas këtij ligji, shkrija lejohet kur ekziston hipotekë (siç është rasti këtu) pas dhënies së pëlqimit nga kreditori apo poseduesit e tjerë të të drejtave pronësore për një rend të ri të prioriteteve në parcelën e re të bashkuar.

Prandaj, ekzistimi i një hipoteke në njërin nga parcelat nuk ka paraqitur pengesë ligjore për ekzekutimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Pretendimi i të pandehurve se përkundër hipotekës ka pasur një peticion për ri-gjykim, shkon në kundërshtim me deklaratën e tyre, përderisa është evidente se peticioni për ri-gjykim mund të parashtrohet kundër një vendimi i cili është i formës së prerë. Ligji mbi procedurën civile dhe Ligji mbi procedurën kontestimore duhet të theksohen këtu, neni 421 dhe 422 të cilët kanë qenë të aplikueshëm deri në vitin 2008 në kohën kur është parashtruar peticioni për ri-gjykim parasheh mundësinë për gjykim, i cili është përfunduar në mënyrë të rregullt përmes vendimit të Gjykatës, sipas propozimit të palës, për më tepër, neni 422 i Ligjit mbi Procedurën Civile si parakusht i kërkesës për ri-gjykim është që gjykimi i mëparshëm ka përfunduar me Aktgjykim të formës së prerë. Duhet të vërehet se kur është ekzekutuar Aktgjykimi i Gjykatës Supreme në fund çështja e ri-gjykimit nuk ka paraqitur asnjë pengesë.

Çdo sugjerim se ekzistimi i një hipoteke ka parandaluar ekzekutimin e Aktgjykimit është po ashtu i padrejtë. Ka pasur vetëm një hipotekë mbi njërin nga parcelat – parcel në pronësi të **J.A.** Është e rëndësishme që secili nga avokatët publik që kanë dëshmuar në gjykatë kanë deklaruar se nuk ka pasur pengesa në ekzekutimin e aktgjykimit të Gjykatës Supreme. Në të vërtetë, nëse kanë menduar që ka pasur pengesa ata nuk do të bënin propozimet për ekzekutim.

Çdo argument potencial që ndryshimet nuk kanë mund të bëhen në kadastër deri në momentin e riposedimit fizik të tokës është po ashtu jovalid. Ndryshimet në kadastër është dashur të bëhen para se të bëhet çkado tjetër nga komuna për të marrë parcelat prapa në posedim fizik të saj. Neni 37 i cili parasheh që, pas ndryshimeve të bëra në kadastër, fleta poseduese (që përkufizon kufinjtë e pronës së marrë) mund të merret dhe mund të inicohet procedura siç përshkruhet në nenin 37. Prona duhet së pari të merret ligjërisht para se të mund të mbrohet ose kthehet fizikisht.

Situata e njëjtë ekziston në Ligjin e ri 03/L-154 – neni 93, i cili parasheh opsionin që pronari të kërkojë dorëzimin e pronës së caktuar nga çdokush që nuk ka të drejtë t'a posedojë atë.

Neni 422 i Kodit Penal të Kosovës parasheh që *Personi zyrtar, i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që t'i shkaktojë dëm personit tjetër ose që seriozisht t'i shkel të drejtat e personit tjetër*

Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 mbi Vetë-qeverisjen Lokale të datës 20 shkurt 2008 Kryetari i Komunës R.M. ka pasur pushtetin të punësojë dhe shkarkojë K.U. si Drejtor i Drejtoratit të Gjeodezisë dhe Kadastrit dhe po ashtu ka pasur të drejtë t'i japë udhëzime lidhur me ekzekutimin e detyrave të Drejtoratit sipas nenit 13 të të njëjtit ligj. Por, duhet të thuhet që, teoritikisht, Përfundimi i R.M.ka mundur të jetë efektiv pa asistencën e K.U. duke pasur parasysh zingjirin komandues në Komunë.

Ligji mbi Vetë-Qeverisjen Lokale parasheh që Kryetari i Komunës përfaqëson dhe vepron në emër të Komunës dhe se duke vepruar në cilësinë e tij zyrtare ai ushtron të gjitha kompetencat që i caktohet Kuvendit Komunal ose komisioneve të tij në mënyrë jo eksplicite. Prandaj, Kryetari i Komunës ka qenë i obliguar të sigurojë që të ekzekutohet Aktgjykimi i Gjykatës Supreme.

Në të njëjtën mënyrë, neni 62 i Ligjit mbi Vetë-Qeverisjen Lokale parasheh që secili drejtorat i komunës duhet të menaxhohet nga një drejtor dhe në pajtim me nenin 9 të “Aktvendimit mbi strukturën e brendshme dhe distribuimit të posteve të punonjësve në organet civile komunale”, të adoptuar nga ana e Kuvendit Komunal në Prizren në seancën e mbajtur më 22 prill 2004. Më tej, neni 62 i Ligjit mbi Vetë-Qeverisjen Lokale përcakton që drejtorët duhet të menaxhojnë drejtoratet e tyre në pajtim me strategjitë strategjike dhe politike të Kryetarit të Komunës. U. nuk ka vepruar sipas nenit 8.7 të Ligjit Nr. 2003/25 mbi Kadastrin të datës 4 dhjetor 2003 i cili përcakton që ndryshimet relevante në Kadastër duhet të regjistrohen posa të shqyrtohet dhe aprovohet dokumentacioni i kërkuar. Në këtë rast, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme është dashur të ekzekutohet menjëherë, ndërsa të dy kanë bërë të kundërtën, duke vendosur ndalesë mbi marrjen me çështjen e pronës pasi është pranuar aktgjykimi i Gjykatës Supreme.

b. Akuza II – Qendra Edukative Arsimore QEA ‘Gulistan’

Alokimi i tokës Qendrës Edukative Arsimore Gulistan është akti i dytë në shpërdorimin e pozitës zyrtare në Komunë nga Kryetari i Komunës R.M., M.K. dhe A.A.in në bashkëpunim. Të tre të pandehurit, duke vepruar së bashku, kanë arritur të fitojnë pronësinë për Komunën e Prizrenit nga Organizata e Punës së Pyltarisë ‘Sharri’ – OPB Ekonomia e Pyjeve.

Organizata e Pylltarisë Sharri është ndërmarrje në pronësi publike e cila sipas ligjit bie nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.⁴⁷ Prandaj, transferimi i tokës pa pëlqimin e Agjencisë së Privatizimit përbën shkelje përderisa ligji i lartpërmendur parasheh si në vijim:

- *Neni 2.1 parasheh që Agjencia 'është e autorizuar për administrimin – duke përfshirë autorizimin për shitjen, transferimin dhe/ose likuidimin – e ndërmarrjeve dhe asetëve të përkufizuar në këtë ligj' që sipas nenit 6.1 (n) përfshin të gjitha ndërmarrjet dhe asetet*

Në letrën njoftuese të Agjencisë Kosovare të Privatizimit të datës 09 shkurt 2012, konfirmohet se parcel në fjalë (Nr. 800/2) është në pronësi shoqërore dhe sipas nenit 5.1 (a) të Ligjit mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit është nën autoritetin administrativ të Agjencisë së Privatizimit, e cila asnjëherë nuk është informuar lidhur me ndonjë transferim të pronësisë të kësaj parcele Komunes së Prizrenit.

Parcela nuk është përfshirë në asnjë plan rregullativ urbanistik dhe të pandehurit po ashtu kanë dështuar t'i binden Ligjit mbi Vetë-Qeverisjen Lokale ku neni 40.2(c) parasheh që në mënyrë që të vendoset mbi një plan investues nevojitet pëlqimi i Kuvendit Komunal. Lidhur me nenin 25 të Statutit të Komunes së Prizrenit Nr. 01/011-5643 të datës 15 gusht 2008 i cili thotë se kërkohet vendimi i Kuvendit Komunal në rastet e nënshkrimit të kontratave, dhe dhënies me qera të pronës komunale.

Në kuptim të kësaj, secili i pandehur ka po ashtu përgjegjësi individuale në alokimin e tokës. Derisa Kryetari i Komunes R.M. ka qenë i obliguar të ndjekë procedurën në alokimin e tokës publike d.m.th të ofrojë pëlqimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe siç është thënë më parë vendimin e Kuvendit Komunal, pavarësisht kësaj ai ka marrë vendim sipas të cilit parcel në Boka Boka ishte marrë në pronësi të Komunes. I pandehuri M.K. ka qenë në dijeni që aprovimi i Kuvendit Komunal ka qenë i nevojshëm për parcelën specifike dhe se kërkohet pëlqimi nga AKP para se të transferohet toka, përkundër kësaj M.K. në cilësinë e Drejtorit të Drejtoratit të Administratës/Zyra për Çështje Pronësore dhe Ligjore e Komunes së Prizrenit, i ka parashtruar kërkesë Drejtorit të Drejtoratit për Gjeodezi dhe Kadastër, A.A., në të cilën ka thënë se do të bëhen ndryshime të menjëhershme në të dhënat kadastrale dhe alokimi i tokës në Boka Boka për shfrytëzim dhe ndërtim të shkollës Qendrës Gulistan. I pandehuri i tretë në këtë vepër, A.A., ka ndjekur udhëzimet e M.K. dhe ka lëshuar vendim duke aprovuar transferimin e tokës edhe pse ka qenë në dijeni se për alokim të tokës ekzistojnë procedura të caktuara që duhet ndjekur. Qëllimi jo i drejtëpërdrejtë i A. në shkelje të rregullave në favour të entitetit privat është i dukshëm nga shpejtësia e procedurave.

⁴⁷ (Ligji nr. 03/L-067 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit)

Ndryshimet janë bërë duke shkelur nenin 3.3 (a) të (ndryshuar në vitin 2003) Ligjit mbi regjistrimin e të drejtave të pronës së paluajtshme (**Ligji Nr. 2003/13**)⁴⁸ i cili parasheh që zyra kadastrale të ketë një tabelë për njoftime publike ku njoftimet mbi kërkesat për regjistrim do të postohen dhe janë të dukshme për publikun. Neni 3.3 (b) përcakton se zyra kadastrale duhet të vendosë çdo njoftim mbi kërkesë për regjistrim në tabelë publike njoftimi së paku për pesë ditë para se të lëshojë vendim që autorizon regjistrimin. Kjo bëhet në mënyrë që palët e interesuara mund të ankohen ndaj bërjes së ndryshimeve.

Kryetari i Komunës në këtë lëndë ka alokuar tokën një entiteti privat, që ka filluar ndërtimin para se të bëhet ndonjë Plan Rregullativ Urbanistik në atë parcelë. Plani Rregullativ Urbanistik lidhur me këtë parcelë ka filluar më datë 19 prill 2011 kur Kryetari i Komunës ka lëshuar një përfundim duke dhënë lejen për të përpiluar Planin Rregullativ Urbanistik për parcelat 800/1, 800/2 dhe 801.

c. Akuza III fabrika e çokollatës ‘Kamila’

P. dhe **M.** kanë thënë Z.S. se kërkohet pëlqimi i Kuvendit Komunal për të alokuar tokën, megjithatë, më datë 15 dhjetor 2010 R.M. ka nënshkruar marrëveshjen për partnership publiko-privat dhe koncesion për shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale.

Nga deklarata e R.M. është kuptuar se ai ka qenë në dijeni që është nevojitur pëlqimi i Kuvendit Komunal në mënyrë që t’i alokohet toka publike një kompanie private, megjithatë, ai ka thënë se ka qenë interes i përbashkët të shtyhet investitori të qëndrojë në Prizren meqë ai ka pasur ofertë të investojnë Maqedonia dhe në këtë mënyrë ai ka dashur t’a mbajë në Kosovë, prandaj ai është munduar t’i arsyetojë veprimet e veta. Kontrata e nënshkruar me Kamila-n ka qenë partnership publiko-privat që është në kundërshtim me ligjin, meqë Kamila është kompani private profitabile dhe nuk zhvillon ndonjë funksion publik. S.P.si bashkëkryes ka qenë në dijeni po ashtu se nevojitet pëlqimi i Kuvendit Komunal, kjo është deshmuar nga E.S. cili ka deklaruar se **P.** i ka thënë atij se nevojitet pëlqimi i Kuvendit Komunal Kuvendi Komunal is needed.

Të dy të pandehurit kanë qenë në cilësi të personave zyrtarë duke punar për Komunën, kështu që kanë kryer veprën penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, duke shfrytëzuar autoritetin e tyre zyrtar duke tejkaluar kufijtë e autorizimeve të tyre dhe duke dështuar në ekzekutimin e detyrës së tyre zyrtare, ndërsa kanë mundësuar përfitimin material për personin e tretë dhe i kanë shkaktuar dëme Komunës.

⁴⁸ (Ligji Nr. 2003/13 MBI AMANDAMENTET DHE PLOTËSIME TË LIGJIT NR. 2002/5 MBI THEMELIMIN E REGJISTRIT TË TË DREJTAVE MBI PRONËN E PALUAJTSHME)

d. 'Konkluzioni' mbi ndalesën ndaj ekspertëve kadastral - Akuza IV

Përfundimi i lëshuar nga R.M. me të cilin ka ndaluar ekspertët kadastral të marrin pjesë në seanca gjyqësore ka qenë në fuqi për një periudhë kohore prej 5 muajsh. R.M., në cilësi të Kryetarit të Komunës së Prizrenit, M.K., në cilësi të Drejtorit të Drejtoratit të Administratës/Zyra për Çështje Pronësore dhe Ligjore dhe A.T., në cilësi të Drejtorit të Drejtoratit të Gjeodezisë dhe Kadastrit të Komunës së Prizrenit, **M.** dhe **K.** kanë vepruar në bashkë-kryerje dhe prandaj kanë shkelur rëndë të drejtat e personave të tjerë. A.T. u ka ndihmuar.

Duke lëshuar Përfundimin dhe duke u pajtuar me këtë të tre të pandehurit kanë shkelur nenin 18 të Ligjit mbi Gjykatat e Rregullta në Kosovë, i cili përcakton se gjykatat mund të kërkojnë ndihmën e entiteteve publike kurdo që është e nevojshme dhe autoritetet e tilla janë të obliguara t'i binden kërkesës së gjykatës dhe vetë përfundimi ka shtyrë ekspertët kadastral të shkelin ligjin dhe të mos i nënshtrohen thirrjeve të gjykatës.

Në të njëjtën mënyrë M.K. dhe A.T. kanë qenë të obliguar mos t'i nënshtrohen përfundimit të Kryetarit të Komunës, meqë vendimi ka qenë thirrje për mos-nënshttrim ndaj gjykatës, duke ndikuar në këtë mënyrë rrjedhën e procedurave në disa lëndë civile që kishin të bëjnë me pronësi mbi pronë.

Lidhur me këtë, Trupi gjykues është i mendimit se **M.** dhe **T.** si zyrtarë komunal kanë qenë në pozitë të kuptojnë se ndalesa ndaj ekspertëve kadastral është shkelje e rëndë, duke vënë në këtë mënyrë ekspertët në një pozitë të paqartë, duke pasur frikë nga humbja e vendit të punës dhe në anën tjetër duke privuar paditësit nga e drejta e tyre kushtetuese për një gjykim të drejtë dhe të shpejtë.

Në këtë kuptim, të tre të pandehurit kanë shkelur ligjin duke tejkalluar kufijtë e autorizimeve të tyre dhe duke dëmtuar palët e treta përmes vendimit mbi ndalimin e ekspertëve kadastral nga pjesëmarrja në seanca gjyqësore, duke kryer në këtë mënyrë veprën penale të Keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar për **M.** dhe **K.**, ndërsa **T.** veprën penale të Ndihmës në kryerje të Keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar. A.T. si person që ka qenë në dijeni për kundërligjshmërinë e një përfundimi të tillë, në vend se të parandalojë faktikisht ekzekutimin e tyre nga përgjegjësia e pozitës së tij, ai ka ndihmuar në zbatimin e tyre duke informuar ekspertët kadastral.

Në fund, përfundimi i tillë nuk ka përfillur vendimin *sui generis* të gjykatës – thirrjen, dhe ka ndikuar në kontest të drejtë civil - gjykim. **M.** dhe **K.** në bashkëpunim kanë përdorur pushtetin e tyre ekzekutiv duke ndikuar në mënyrë jo të drejtëpërdrejtë në kontest civil që ka rezultuar në privim të të drejtave të pjesëmarrësve nëkontest civil.

Zbatimi i ligjit penal

Veprat penale janë kryer para datës 1 janar 2013, do të thotë që Gjykata është dashur të përdor nenin 3 të Kodit Penal përkitazi me testin se cili ligj është më i favorshëm për secilin të pandehur. Ligji më i favorshëm është ai sipas të cilit parashihet caktimi i ndëshkimit më të butë. Në praktikë do të thotë krahasimi i ndëshkimeve të mundshme por jo vetëm nga aspekti i kohëzgjatjes së dënimit por po ashtu edhe nga aspekti i llojit të ndëshkimit etj. Neni 422 i Kodit të ri Penal, për veprën penale të Keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, përcakton dënimin prej 6 muaj deri në 5 vite burgim. Pasojat nuk kanë ndryshuar kualifikimin. Në anën tjetër, neni 339 i Kodit Penal të Kosovës reflekton pasojat e kësaj vepre penale. Për këto arsye kodi i vjetër është më i favorshëm, në rastet kur pasojat si përfitim material/dëme janë më të vogla se 5000 Euro. (paragrafi 2). Kjo vlen edhe për shkelje të rënda të drejtave të personit tjetër. Por, në anën tjetër, kodi i ri penal është më pak i favorshëm kur përfitimi material, dëmi tejkalon 5000 EURO. Dëmi, përfitimi material dhe shkelja e rëndë e të drejtave të personit tjetër janë marrë parasysh. Kodi i ri penal është më i favorshëm për veprat penale të kryera nga R.M., A.A., K.U. dhe M.K.. Kodi i vjetër penal është më i favorshëm për S. P. dhe A.T. siç është e dukshme nga pasojat e gjetura në Akuzat specifike.

Vepra penale në vazhdim

Trupi gjykues është i mendimit se R.M. dhe M.K. kanë kryer vepër penale në vazhdim siç është përcaktuar në nenin 81 të Kodit Penal sepse kanë ekzistuar më shumë se 2 kushte. R.M. dhe M.K. kanë shfrytëzuar situatën e tyre si zyrtarë publik në Komunën e Prizrenit, konkretisht në lokalet e zyrës. Qëllimi (i drejtëpërdrejtë/jo i drejtëpërdrejtë) i të dy atyre ka qenë përfitimi material për të tjerët dhe ka qenë i njëjtë. Objekti i keqpërdorimit të pozitës zyrtare është i dukshëm në çdo vepër penale të Keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar.

Bashkë-kryerja dhe ndihma

K.U. dhe A.T., prej funksioneve të tyre, nuk kanë krijuar kushtet për kryerjen e një vepre të tillë penale. K.U. nuk ka përdorur autoritetin e tij për të ndaluar ekzekutimin e memos së R.M.nr.o 621/08 edhe pse ka qenë në dijeni mbi kundërligjshmërinë e një memoje të tillë dhe edhe pse ka qenë në dijeni se pozita e tij i ka lejuar mos-nënshtrim ndaj udhëzimeve të kundërligjshme. Në anën tjetër, ai nuk ka kontribuar në mënyrë substanciale në veprimet e R.M. I njëjti argument duhet të përdoret edhe në rastin e A.T. Përfundimi ndalues ka qenë falë ndihmës së Z.T. edhe pse ai ka qenë në dijeni mbi kundërligjshmërinë e në vendimi të tillë.

Bashkë-kryerja në kryerjen e veprës kërkon kontribut substancial të personave të tjerë. Ky kontribut substancial do të thotë në këtë rast specifik lëshimi dhe nënshkrimi i

dokumenteve vendimtare. R.M., M.K., S.P. dhe A.A. kanë lëshuar dhe nënshkruar dokumenta vendimtar të cilët kanë qenë të nevojshëm për kryerjen e veprës penale. Veprimi i një të pandehuri nuk mund të përfundojë pa kontrbutin e të pandehurit tjetër. (Vepra penale e përshkruar nën Akuzën 1 është kryer nga R.M. individualisht, K.U. vetëm i ka ndihmuar atij. Nga këto arsye, Trupi gjykues ka gjetur se R.M. ka kryer veprën penale të Keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar në vazhdim vetëm pjesërisht në bashkë-kryerje.)

6. Propozimet e refuzuara

R.M.

Pretendimi i Avokatit mbrojtës R.B. kryesisht fokusohet në elementet e veprës penale, posaçërisht *'mens rea'*. Z.B. ka deklaruar se, në mënyrë që të kryejnë veprën penale, personat zyrtarë duhet të shfrytëzojnë autorizimet, tejkalojnë kompetencat apo të dështojnë në kryerjen e detyrave zyrtare sipas të dy kodeve në mënyrë që:

- Të pëfitojnë ndonjë lloj profiti për vete apo ndonjë person tjetër,
- Të shkaktojnë dëm një personi tjetër,
- Të shkelë rëndë të drejtat e një personi tjetër

Pa ekzistimin e qëllimit siç është paraparë në ligj vepra penale nuk ekziston. Gjatë tërë procedurës nuk ka pasur prova që kanë mundur të mbështesin elementin e dashjes në anën e profesor R.M.

Për më tepër, avokati ka shtuar se përpiluesi i aktakuzës dhe përfaqësuesi i saj në shqyrtim kryesor mundohet përmes dëshmitarëve, me të cilën kërkohet të komentojë dispozitat ligjore apo aktet e tjera normative, të konfirmojë se aktivitete të caktuara të Kryetarit të Komunës apo zyrtarëve të tjerë kanë shkelur ligjin, pa marrë parasysh nëse është ligji procedural apo substancial. Prandaj, pjesa dërmuese e shqyrtimit kryesor ka marrë karakterin e një konflikti administrativ, sipas kërkesës së parashtruar për vlerësim të ligjshmërisë së akteve individuale administrative me të cilat organet kompetente të administratës publike, vendosin mbi të drejtat, obligimet dhe intereset ligjore të personave fizik, juridik apo të tjerë, dhe legjitimitetin e aktiviteteve të organeve administrative. Shkelja e Ligjit procedural ose substancial ku të drejtat e personave fizik dhe juridik janë shkelur nuk do të thotë kryerje e veprës penale të Keqpërdorimit të detyrës apo autoritetit zyrtar, njëjtë, siç nuk do të thotë se çdo shkelje e bërë nga Gjykatësi përbën veprën penale. Vetëm shkelja e qëllimshme e Ligjit, me qëllime që janë paraparë me Ligj, përbën veprën penale. Bazuar në provat e

administruara nuk ka qenë e mundur të konfirmohet dashja për të përfituar profit për veten apo personin tjetër apo për t'i shkaktuar dëm personit të tretë. Këto rrethana që përfaqësojnë elementet bazike të kësaj vepre penale, pra pa këto nuk ka vepër penale, janë të supozuara pa ndonjë mbështetje logjike që do të mund të ishte gjetur në provat e administruara.

Duke u munduar që këto supozime të pranohen si të vërteta, siç shihet nga aktakuza dhe siç është munduar të bëhet nga përfaqësuesi i aktakuzës, në disa raste është Komuna e Prizrenit ajo që është treguar si palë e dëmtuar dhe në disa raste të tjera Komuna është paraqitur si përfitues i dobisë materiale/pronësore ndërsa si palë e dëmtuar ndërmarrja e pylltarisë “Sharri”, e cila në fakt nuk ekziston, apo AKP-ja, përfaqësuesi is ë cilës nuk e pa si të arsyeshme të paraqitet në këtë gjykim, kështu ne po ashtu kemi se përfituesi është investitori i huaj, dhe për këtë qeveria e Kosovës është zotuar të ketë investime nga jashtë, përfshirë çdo shtet, veçanërisht shtetet në tranzicion të Ballkanit.

Shkelja e të drejtave dhe interesi ligjor i palëve me veprimet e autoriteteve administrative gëzon mbrojtjen ligjore sipas ligjit mbi konfliktet administrative.⁴⁹ Legjitimiteti i akteve dhe aktiviteteve të organeve administrative vlerësohet bazuar në aplikimin e palës që tregohet në kërkesë/padi të adresuar gjykatës kompetente. Nëse do të shkeleshin të drejtat e personave fizik apo juridik apo palëve të tjera konflikti kundër këtyre akteve dhe aktiviteteve do të inicohej kundër organeve administrative siç është inicuar nga ana e prokurorisë së EULEX-it në Prizren kundër përfundimit të Kryetarit të Komunës së Prizrenit nr. 01/06-8121, të datës 02.08.201, përderisa procedura e inicuar⁵⁰ është suspenduar.

Më tej, Avokati mbrojtës **B.** elaboron mbi veprimet specifike, akuzë për akuzë, të klientit të tij, Kryetarit të Komunës **M.** Duke iu referuar veprimit të parë, përderisa deklaroi se nuk është obligim i apo kompetencë e Kryetarit të Komunës të merret me regjistrimin e pronës së paluajtshme në regjistrin e të drejtave pronësore, ai më tutje pretendon se ndryshimet në regjistrin kadastral për këto prona të paluajtshme në asnjë mënyrë nuk janë varur nga dashja e Kryetarit të Komunës.

Trupi Gjykses vlerësoi se Ligji mbi Qeverisjen Lokale (Nr. 03/L-040) i datës 20/02/2008 i jep autoritet Kryetarit të Komunës të marrë në punë dhe t'a largojë nga puna K.U. si Drejtor i Drejtorisë së Gjeodezisë dhe Kadastrit dhe poashtu kishte të

⁴⁹ Ligji nr. 03/L-202 për konfliktet administrative i datës 16 shtator 2013.

⁵⁰ Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës i është bashkëngjitur kërkesës për të hedhur poshtë aktakuzën të datës 15 prill 2013 të parashtruar në Gjykatë nga avokati mbrojtës i të akuzuarit, Profesori R.M.

drejtën që të i jep udhëzime atij në lidhje me kryerjen e detyrave të Drejtorisë, Neni 13 i po të njëjtut ligj.

Shkeljet e bëra nga **M.** përfshijnë Nenin 58 të se Ligjit mbi Qeverisjen Lokale i cili merret me “Përgjegjësitë e Kryetarit të Komunës” i cili thotë se Kryetarët e Komunës “veprojnë në emër të Komunës”, dhe se duke vepruar në cilësinë e tij zyrtare “ai ushtron të gjitha kompetencat që nuk janë decidivisht të caktuara nga Kuvendi Komunal apo komisionet e saj.”

Trupi Gjykses, derisa i vlerësoi pretendimet e bëra nga Avokati Mbrojtës vie në përfundim se të drejtat, obligimet dhe kompetencat e Kryetarit të Komunës janë shumë më të mëdha sesa ato që pretendohen nga mbrojtja, duke thënë se ai nuk ishte në dijeni për Aktgjykimin është edhe një here e pabesueshme, duke pasur këtë në mend, shumica e dëshmitarëve dinin për aktgjykimin dhe avokati publik komunal ka dërguar letër tek zyra e Kadastrit duke kërkuar ekzekutimin e aktgjykimit.

Qëndrimi i tij gjatë mbrojtjes se edhe sikur ai të kishte ditur për aktgjykimin, ishte zyra e Kadastrit ajo e cila do të duhej të merrej me të, prapë nuk mund të qëndroj, i pandehuri **M.** është njeri i shkolluar, profesor dhe ai ishte autoriteti i Komunës. Trupi Gjykses është i vetëdijshëm se ai nuk mund të kontrolloj gjatë gjithë kohës çdo vendim i cili merret në Komunë, sidoqoftë, ky nuk ishte ndonjë vendim i rëndomtë. Duke pasur parasysh se një aktgjykim final nga Gjykata më e lartë e shtetit, nuk është ekzekutuar për disa vite është plotësisht e papranueshme, duke a marrë parasysh gjithashtu se parcela e tokës ishte e zëvendësit të tij, **M.K.**, hedh poshtë mbrojtjen e tij. I pandehuri **M.** gjatë gjithë kohës është munduar ta hedhë topin tek mvartësi i tij **K.U.**, i cili më pastaj përdori disa pengesa ligjore me të cilat e bëri ekzekutimin e pamundur, sidoqoftë, Trupi Gjykses konsideron se ishte obligim i Kryetarit të Komunës që të siguroj ekzekutimin, dhe duke mos e bërë këtë, ajo konsiderohet të jetë shkelje nga dikush që e udhëheq Komunën.

Në pikën e dytë të akuzës Avokati Mbrojtës thotë se vepra mund të kryhet duke tejkalluar kompetencat ose duke dështuar së kryeri detyrat ashtu siç kërkohet. Në lidhje me këtë ai më tutje shton se, toka e cila i ishte ndarë fabrikës së çokollatës ishte tokë ndërtimi, kështu që ligji mbi tokën ndërtimore thotë se një tokë e tillë duhet të administrohet nga Komuna, dhe më pastaj mbrojtja pretendon se ishin dërguar disa kërkesa nga komuniteti lokal pasi që toka në “Boka” ishte vend grumbullim i mbeturinave dhe kjo paraqiste rrezik për komunitetin. Për më tepër, ishte pronë shoqërore, dhe ishte duke u përdorur nga Organizata Punuese “Sharri”, por askush nuk kishte të drejtë të kërkonte pronësinë e pronës por vetëm të drejtën për përdorim ose posedim të saj për një kohë të caktuar. Duke e thënë këtë, mbrojtja u mundua ta çrrënjos faktin se nevojitet pëlqim nga pylltaria Sharri apo pëlqim nga Agjensioni Kosovar i Privatizimit.

Ztr. **B.** tha se çështja e bartjes së tokës është akt administrativ i lëshuar përmes procedurës administrative. Si edhe në procedurat gjyqësore, ashtu edhe në ato procedurale, kur lëshohet një vendim, mund të ndodhë që ligji mos të implementohet drejtë, të shkelet ligji apo procedura mos të ndiqet në pajtim me ligjin. Pra, sipas tij, kundër çdo vendimi, të jetë ai administrativ apo gjyqësor, jepet e drejta e ankesës. Nuk kishte ankesë kundër, as nga Agjensioni Kosovar i Privatizimit e as nga Ndërmarrja Punuese e Pylltarisë “Sharri” OBPB Ekonomia e Pyjeve (edhe pse letra nuk ekziston), pra është në fuqi. Trupi Gjyqësor konsideron se i pandehur në këtë çështje, ishte në dijeni për shkeljen e zotimeve të tij, dhe duke vepruar, të gjitha elementet e veprës penale ishin përmbushur, kjo nuk është një situatë kur ai veproi pa dëshirë ose gabimisht dhe më pastaj u mundua ta përmirësoj, përveç kësaj, veprimet e tij shkaktuan një masë të caktuar dëmi dhe ishte duke përfituar nga pozita e tij.

Për më tepër, mbrojtja e Z. B. përmend protestat e fshatarëve që të përmirësohet pjesa e tokës që përdorej si vend grumbullim i mbeturinave dhe që të hiqen mbeturinat; pra ndarja e tokës shkollës private ishte parë si zgjedhje. Vlen të theksohet se çështja që duhet të vlerësohet këtu është ajo se transferi dhe ndarja e tokës e bërë në kundërshtim me ligjin.

Duke ju referuar pikës tre në Aktakuzë, duhet vlerësuar edhe një herë ndarjen e tokës fabrikës së Çokollatës “Kamila” pa pëlqim të Kuvendit Komunal dhe pa respektuar procedurat ligjore, ku kontrata për një partneritet privat ishte nënshkruar. Avokati Mbrojtës tërheq vëmendjen tek kontrata dhe se kjo pasuri e paluajtshme ishte regjistruar nën emrin e Sekretariatit Federativ të Mbrojtjes Popullore të ish-Jugosllavisë (nëse përfaqësuesi i aktakuzës, në rastin e pikës një të akuzës, konsideron se provat nga zyra e Kadastrit tregojnë të drejtën e pronësisë të personit në emër të të cilit është regjistruar prona e paluajtshme. Pra, kur thuhet se Komuna nuk mund ta përdor apo administroj atë, atëherë kush është pronar i tokës. Duhet të theksohet edhe një herë se prona e cila është pronë shoqërore, siç u përshkrua, ishte nën administrim të vetëm të Agjensionit Kosovar të Privatizimit, kështu që, kërkohet aprovimi i tyre mbi dhënien me qira të tokës tek kompanitë private. Përveç kësaj kontrata e nënshkruar është e një partneriteti privato – publik, derisa e vetmja bazë për përdorimin e partneritetin publiko – privat është natyrisht kur kontraktuesi privat kryen aktivitetet ekonomike të cilat përndryshe do të kryheshin nga autoritetet shoqërore. Edhe një herë është evidente nga deklaratat e dëshmitarëve se i pandehuri thjesht kishte vendosur të anashkaloj Kuvendin Komunal dhe procedura tjera më të rëndësishme të cilat kërkohen.

Avokati Mbrojtës thotë se R.M. nënshkroi këtë marrëveshje në cilësinë e Kryetarit të Komunës; sidoqoftë, si kontratë ajo ishte përpiluar nga zyrtarët ligjor të Komunës së Prizrenit. Ai më tutje pretendon se nuk ka dilemë se nuk është përpiluar nga vet Kryetari i Komunës, Profesor R.M., por se nuk është konstatuar se kush ishte

përpiluesi i kontratës, sepse asnjëri nga zyrtarët ligjor nuk pranoi se ishin autor të saj. Në lidhje me këtë Trupi Gjyqës pranon se kontrata, para se të nënshkruhej, ishte diskutuar si e tillë nga Kryetari i Komunës dhe mvartësit e tij, ata ishin në dijeni se një ndarje e tillë e tokës si dhe kontrata ishin në kundërshtim me procedurat, por prape se prapë, vendosën ta procedojnë. Është evidente nga dëshmitë e marra se kishte qëllim që të përfitohet nga pozita e tij dhe të përfitoj për personin e tretë, në këtë rast një biznes kompletisht privat, e cila prodhon çokollata për fitim të tij personal.

Për sa i përket pikës së katërt që ka të bëjë me vendimin e Kryetarit të Komunës, duke i ndaluar ekspertët e kadastrit që të marrin pjesë në seanca gjyqësore. Avokati Mbrojtës pretendon se para lëshimit të këtij vendimi nga Kryetari i Komunës, nuk kishte bord të drejtorëve si një organ ekzekutiv. Pra kishte mbledhje të organizuara nga Kryetari i Komunës, zëvendësit e tij si dhe 9 drejtor të drejtorive. Gjatë njëres nga mbledhjet, ishte nxjerrë një konkluzion me të cilin ishte urdhëruar që Drejtori i Gjeodezisë deh Kadastrit, me një vendim të posaçëm të ndalohej pjesëmarrja e ekspertëve të Kadastrit nga Drejtoria e Gjeodezisë dhe Kadastrit, që në cilësi të zyrtarëve komunal të kryejnë ekspertizat gjyqësore për nevoja të gjykatave kompetente. Pra sipas avokatit, përgjegjësia penale ishte dashur të shpërndahet barazi në mes të të gjithë pjesëmarrësve. Për më tepër , avokati thotë se në atë kohë kishte zyra tjera të Kadastrit për gjeodet privat që do të mund të merreshin me çështjet që kërkoheshin nga gjykata. Trupi Gjyqës erdhi në përfundim se **M.** lëshoi vendim mbi propozimin e **M.K.**, duke qenë në dijeni për pasojat që do të shkakttoheshin, dhe duke e shkelur drejtë për drejtë ligjin, derisa dihet edhe nga njerëzit e pa shkolluar se thirrjet e gjykatës duhet të respektohen. Është evidente se me dhënien e konkluzionit ai keqpërdori pozitën e tij zyrtare edhe një here duke shkaktuar indirekt dëme palëve që ishin në procedurë gjyqësore dhe duke i shkaktuar gjykatës që ta shtyjë seancat për periudha kohore prej muajsh. Vetëm me vonë kur situata behej më serioze ai pranoi se kishte nevojë që të merren në konsideratë edhe një herë të bërat e tij dhe të gjendet një zgjedhje.

- **S.P.**

S.P.akuzohet në pikën e tretë duke e vërtetuar Kryetarin e Komunës në mënyrë të paligjshme i dha tokë fabrikës së Çokollatës “Kamila”. Avokati Mbrojtës i **Z. P.** , **S.B.** dha fjalën e tij përfundimtare më 12 Shkurt 2014. Avokati Mbrojtës fillimisht tha se në kohën kur dyshohet të ketë kryer ai veprën penale nga i akuzuari, Kodi i Përkohshëm i Procedurës ishte në fuqi dhe se kjo ishte sanksionuar me Nenin 339. Me Kodin e ri, kualifikimi i veprës jep një përshkrim më të gjerë të veprës dhe se sipas kodit të vjetër dhe të riut elementi esencial i kësaj vepre konstatohet me faktin se kryerësi i veprës ka marrë përfitim material për vete apo dike tjetër. Avokati Mbrojtës tërhoqi vëmendjen në nevojën e ndërtimit të shkollës së re dhe se investitori kishte tashmë kushte shumë më të mira që i ishin ofruar në shtetin fqinjë të

Maqedonisë dhe se kishin lejen nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Kontrata ishte në interes të qytetarëve të Prizrenit sepse si rezultat i këtij ndërtimi, mbi 100 njerëz ishin punësuar, gjë për të cilën përfitonte Komuna.

Avokati më tutje thotë se Komuna e Prizrenit kishte interes publik nga ndërtimi i fabrikës , e cila nëse pas shtatë viteve, kontrata me kompaninë nuk përtërihet, sipas kushteve të reja dhe pas skadimit të 10 viteve, lokalet e shkollës lihen si pronë e Komunës sipas kontratës së nënshkruar nga të dy palët. Z. B. më tutje citon ligjin numër 03/L.40, Neni 62.3, Drejtorët e menaxhojnë dhe udhëheqin Drejtoritë në pajtim me udhëzimet strategjike dhe politike të Kryetarit të Komunës dhe në pajtim me ligjin dhe rregulloret e zbatueshme, deri sa kontrata e punës së të akuzuarit, nën pjesën “obligative”, është e përshkruar dhe citon se “*i punësuarit ka obligim të kryej dhe ekzekutoj urdhërat e eprorit të tij/saj*”.

Trupi Gjykues duhet të nënvizoj se nuk është çështja në vlerësimin e përfitimeve që Komuna do të kishte nga punësimi i njerëzve e as nga ndërtimi i ndërtesave dhe pastrimi i parcelës nga mbeturinat, çështja në fjalë është ndarja e tokës dhe procedura që duhet të ndiqet gjatë procesit të ndarjes së tokës. Është e qartë se disa procedura të caktuara të prokurimit është dashur të ndiqen para ndarjes së tokës, pëlqimi i Kuvendit Komunal gjithashtu nevojitej, dhe bazat e partneritetit publiko – privat kanë mundur të mos përdoren në një kontratë të tillë. Trupi Gjykues është i vetëdijshëm se i pandehuri pretendon se nuk e kishte ditur as cilat ishin kushtet dhe as që e ka lexuar kontratën që ai e ka nënshkruar (kontratën e parë), sidoqoftë përgjegjësia nuk mund të evitohet duke dhënë deklaratat të tilla, përderisa i pandehuri ishte Drejtor i Drejtoratit për Urbanizëm e Planifikim Hapësinor në Komunën e Prizrenit, duke qenë në një pozitë kaq të rëndësishme ai do të duhej të ishte i vetëdijshëm për përgjegjësitë që e kishte, për më tepër gjatë marrjes së tij në pyetje ai qartë dëshmoi se ai ishte në dijeni të procedurës së prokurimit por se ky rast ishte i veçantë. Trupi Gjykues nuk u bind me deklaratën e tij, ai e konfirmonte atë që e ka thënë Kryetari i Komunës, duke e ditur se ata plotësisht e kishin shkelur ligjin.

- **A.A.**

A.A. ishte i akuzuar në pikën dy të akuzës derisa, sa ishte ai në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Kadastrit dhe Gjeodezisë në Komunën e Prizrenit, ishte bartur prona nga Organizata Punuese e Pylltarisë “Sharri” tek Komuna e Prizrenit, dhe më pastaj duke e dhënë me qira tokën për periudhë të gjatë kohore qendrës edukative shkollore Gulistan. Avokati Mbrojtës Z. R.H.thotë se edhe Kryetari i Komunës M.ka thënë se A.A. nuk ka marrë pjesë në vendim marrje kur ishte përfunduar kontakti në mes Komunës së Prizrenit dhe QE “Gulistan”. Në lidhje me këtë kërkesë ai theksoi se kërkesa për ndarje të parcelës tokësore për Qendrën Edukative daton që nga 13.05.2009 nën numrin 09/05/051302 dhe vendimi për ndarje të parcelës tokësore

për ndërtim të QE “Gulistan” ishte marrë nga Kuvendi Komunal i Prizrenit më 18 Korrik 2009, kjo pra ishte negociimi i bërë dhe vendimi ishte marrë në kohën kur i akuzuari A.A. nuk ishte pjesë e strukturave të vendim – marrjes. Në atë kohë ai ishte asistent profesional në Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastrit në Komunën e Prizrenit. Pra, origjina e ndarjes së tokës për QE “Gulistan” del nga kohë e mëhershme dhe i akuzuari kishte njohuri për të, por vetëm jo-zyrtarisht. Pra, kompetencat e këtyre organeve janë të definuara në pajtim me ligjin mbi vet qeverisjen lokale si dhe Statutin e Komunës, që nënkupton se organet kryejnë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë siç parashihet me ligj.

I pandehur A.A. tha se vendimet ishin marrë dhe kur ato ishin marrë nga këto organe, nuk binin nën kompetencat e mija. Ai citoi Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-040 Neni 10 të këtij Ligji, i cili përcakton organet komunale, më saktësisht Neni 10: “ Organet e komunës janë Kuvendi Komunal dhe Kryetari i Komunës”. Dhe për më tepër neni 11 i ligjit të njëjtit thotë se: “ Kuvendi Komunal dhe Kryetari i Komunës kanë të drejtë të miratojnë akte dhe të ndërmarrin cilën do masë implementuese brenda fushave të kompetencave të tyre, të gjitha aktet komunale duhet të jenë në pajtim me sistemin ligjor dhe kushtetues të Republikës së Kosovës”.

Z. A. tha se ushtronte detyrën e drejtorit të Kadastrit, duke u bazuar në detyrat që ai duhej të kryej, ai nuk ishte organ që e njihnte ligji, që do të merrte vendime në emër të një autoriteti më të lartë, që nënkupton se nuk ishte kompetencë e tij që të vë në dyshim vendimet e marra më herët si dhe kompetencën. Asnjë ligj nuk thotë se organet më të ulëta apo dikush që ushtron detyrën mund të ekzaminoj apo vlerësoj ligjshmërinë e organeve më të larta komunale ose organet e nivelit të njëjtit. Vetëm autoritetet mbikëqyrëse duhet ta kenë këtë të drejtë sipas nenit 80 dhe 81 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale. Ai tha se ishte në dijeni se procedura ishte duke u zhvilluar në mënyrë të shpejtë, por ai si zyrtar, kishte vetëm obligimin që të sigurohet që një vendim i ligjshëm mbi transferimin e pronës ishte marrë me parë, që ishte vendimi i Kryetarit të Komunës të bart pronën tek Komuna si dhe dokumentet përcjellëse ishin bashkangjitur dhe se ai nuk kishte të drejtë e as obligim që të shikonte më thellë në këtë çështje.

Trupi Gjyqësor vëren se Neni 3 i Ligjit për Themelimit të Regjistrimit të Drejtave të Pronës së Paluajtshme obligon Zyrën Kadastrale Komunale të refuzoj regjistrimin nëse dokumentacioni i paraqitur nuk është i mjaftueshëm që të dëshmoj se validitetin e kërkesës, ose nëse ndonjë dokument tjetër mbështetës është i dyshueshëm.

Veç kësaj, Neni 3.3 i Ligjit të Regjistrimit të Drejtave të Pronës së Paluajtshme kërkon që zyra kadastrale mban një tabelë publike ku kërkesat për regjistrim duhet të njoftohen dhe të jenë të dukshme për publikun. Kështu që, Trupi Gjyqësor është i bindur se i pandehuri A. ishte në dijeni qysh nga fillimi se toka ishte marrë në mënyrë

të kundërligjshme, dhe e dinte paraprakisht se bartja e tokës duhej të i nënshtrohej disa procedurave para se të regjistrohej në pronësi të Komunës. Për më tepër, ai ishte avokat i diplomuar, lista poseduese tregonte se ishte prone shoqërore dhe ai e dinte se për një bartje e tillë nevojitej pëlqimi i kuvendit Komunal.

Kështu që, Trupi Gjykses është i mendimit se i pandehuri me dijeni u pajtua me Kryetarin e Komunës dhe të pandehurin tjetër M.K., në marrjen e tokës në mënyrë të kundërligjshme dhe bartjen e saj tek Komuna.

- **K.U.**

I pandehuri K.U. i përfshire në pikën e parë të akuzës ishte mbrojtur nga B.S. (procesverbali i 11 Shkurtit 2014), duke ju referuar Aktgjykimit të Gjykatës Supreme si dhe shtyrjen e ekzekutimit për disa vite. Mbrojtja e tij në këtë çështje ishte në atë mënyrë që sipas ligjit 2003/25, Neni 16 pika 16.5 si dhe bartja e tokës mund të regjistrohet vetëm nëse parcelat e tokave në fjalë janë të lira nga hipoteka apo qfar do lloji tjetër të garancioni, parcela tokësore që ishte e J.A. ishte nën hipotekë. Kjo pjesë e pretendimit tashmë ishte vlerësuar nga Trupi Gjykses dhe ishte e qartë se vendimi i Gjykatës Supreme ishte i ekzekutueshëm, edhe me një hipotekë aktgjykimi i Gjykatës Supreme nuk mund të ekzekutohet siç thuhet në konstatimet e më sipërme ligjore. Qëndrimi i këtij Trupi Gjykses është se qëllimi që qëndron prapa mos-ekzekutimit të aktgjykimit të prerë ishte, pas asnjë dyshim, që të sjellë përfitim për Z. M.K.n i cili ishte zëvendës Kryetar Komune në atë kohë. Veprimet e K.U. nuk mund të atribuohen në lidhje me këtë për mungesë dijeni, e as pengesave ligjore të pretenduara nga ai, pasi që aktgjykimi ishte duke qëndruar, aty, në Komunë për disa vite. Kështu që, Trupi Gjykses është i bindur se R.M. dhe K.U. e dinin që të dy, se kolegu i tyre është duke përfituar drejtë – për – drejtë nga shtyrja e ekzekutimit të aktgjykimit dhe pretendimet e tij duhen që poashtu të hedhen poshtë.

- **A.T.**

I pandehuri **A.T.** mbrojt nga **S.M.**, avokati e fokusoi mbrojtjen e tij në elementet e veprës penale, të cilat sipas tij mungojnë, më saktësisht materiali i përfituar për veti apo personin e tretë si dhe akuzat për dëm. Ai për më tepër tha se nuk ka prova se i akuzuari ka kryer veprën penale në fjalë dhe se në veprimet e tija, elementet e veprës penale nuk janë të formuara në pajtim me Nenin 364 paragrafi 1 pika 1.1 dhe 1.3 të Kodit të Procedurës Penale. Në lidhje me A.T. i cili ishte zyrtar në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Gjeodezisë dhe Kadastrit në Komunën e Prizrenit, Trupi Gjykses e pat paksa të vështirë gjatë pleqërimit, pasi që në të gjitha veprimet e ndërmarra, ai ishte një lloj ndërmjetësuesi; sidoqoftë, Trupi Gjykses nuk mundi që poashtu të përjashtoj përgjegjësitë e tij. Është e vërtetë se konkluzioni e shtyri A.T. që të lëshoj një vendim mbi ndalimin e Ekspertëve të Gjeodezisë Komunale, sidoqoftë, vet

konkluzioni ishte i kundër ligjshëm dhe kjo u dëshmuar gjatë seancës dëgjimore, nga dëshmitari, që kopja e konkluzionit u ishte shpërndarë gjeodetëve nga **A.T.**, ose personalisht, ose përmes **B.B.**

- **M.K.**

I pandehuri **K.** ishte i akuzuar në pikën dy dhe katër të akuzës dhe ai u përfaqësua nga dy avokat mbrojtës, **P.** dhe **N.**

Avokati Mbrojtës **P.** në mbrojtjen e tij u fokusua në elementet e veprës penale, më saktësisht ai tha se në mënyrë që vepra penale e Shpërdorimit të pozitës zyrtare apo autoritetit të ekzistoj- duhet të ketë veprime të caktuara të kryerësit potencial ose veprime individuale në bashkëpunim, të kualifikuara dhe përshkruara ndaras: Shpërdorimi i pozitës zyrtare, Tejkalimi e kufijve apo autoritetit dhe Mos kryerja e detyrave zyrtare.

Avokati për më tepër shton se elementi më i rëndësishëm që të ekzistoj vepra penale në fjalë është caku eventual i kryerësit eventual që vepron në njërin nga mënyrat e cekura më lartë, me qëllimet si në vijim:

- që të përfitoj për vete apo një person tjetër
- që të i shkaktoj dëm një personi tjetër
- që të shkelë rëndë të drejtat e një personi tjetër

Pra qëllimi duhet të jetë personal dhe i ndërmarrë nga personi zyrtar që të përfitoj ndonjë të mirë për vete, një person tjetër ose të i shkaktoj dëm një personi tjetër. Për më tepër **P.** shton se i akuzuari M.K. si Drejtor i Administratës së Përgjithshme, në asnjë mënyrë nuk ka mund të jetë i implikuar në ndonjë veprim që ka të bëjë me ndryshimet kadastrale të bëra në lidhje me bartjen e pronësisë së tokës në emër të Komunës, kur ka të bëjë me bartjen e pronësisë “Gulistan”, sepse pushteti dhe autoriteti që del nga pozita e tij ne menaxhment të lartë, pra si Drejtor i Administratës së Përgjithshme, nuk e lejojnë një gjë të tillë. Sidoqoftë, për Trupin Gjykesor i pandehuri ka dështuar që të marrë hapat e nevojshëm dhe të parandaloj kryerjen e veprës penale për derisa është e qartë se vendimi që të ndahet toka, shkoi përmes zyrës së tij, e në vend që të i adresohet kjo çështje Kryetarit të Komunës, ai i udhëzoi mvartësit e tij që të kërkojnë nga drejtorja e Gjeodezisë dhe Kadastrit që menjëherë të bëjnë ndryshimet, duke e ditur se procedura nuk ishte përfillur përshtatshëm. Avokati Mbrojtës **B.N.** në argumentet e mbrojtjes së tij për një pjesë të mirë i referohet veprës së parë të akuzës, edhe pse klienti i tij nuk ngarkohet me atë vepër. Avokati **N.** thotë se akuza mbi bartjen e tokës është pa ndonjë mbështetje, sepse kjo çështje pa i marrë parasysh pretendimet si dhe sqarimet e pretenduara që kanë të bëjnë me kompetencat e Kuvendit, nuk janë kompetenca të tij, pra, nga ky klient nuk

ka vepër të kryer. Ai për më tepër shton se menaxhimi i Pronave është kompetencë ekskluzive e Kryetarit të Komunës si dhe qeverisë së Kosovës.

Përveç kësaj, **Z. N.** thotë se toka ishte e rregulluar me dispozitat ligjore që përfshinë poashtu pronën e cila menaxhohet nga Agjensioni i Pylltarisë së Kosovës (APK). Agjensioni i Privatizimit nuk ka pasur dhe nuk ka ndonjë të drejtë menaxhimi, për sa i përket parcelës në pronën e APK-së. Avokati Mbrojtës i referohet Ligjit mbi Pylltarinë – ligji nr. 2003/3 si dhe Udhëzimit Administrativ 2000/23 të UNMIK-ut i vlefshëm para ligjit të përmendur. Duhet të sqarohet se ligji në të cilin pretendohet të jetë e bazuar aktakuza- Ligji nr. 04/L-144 mbi dhënien në shfrytëzim dhe ndërrimin o pronës së paluajtshme të komunës, është aprovuar me 28 Tetor 2010 dhe është publikuar më 30.11.2010 si dhe ka hyrë në fuqi më 15.12.2010 (Neni 15 i ligjit, shih datën e publikimit- Gazeta Zyrtare nr. 89 2010). Pra vendimi i Kuvendit respektivisht aktvendimi i Kryetarit të Komunës nr. 01/370 të datës 24.11.2010 nuk ka asgjë të bëjë me këtë ligj.

Për më tepër avokati bën komente në lidhje me disa fakte të cilat nuk janë specifike për çështjen dhe ai me pastaj elaboron mbi shkallën e dëmit në bazë të ekspertizës.

Trupi Gjykses tashmë ka elaboruar në këtë çështje se kush ka kompetenca të administroj dhe të merret me tokën, në këtë rast toka e ndërmarrjes shoqërore punuese e pylltarisë Sharri. Është qëndrim i vendosur i panelit se parcelat tokësore do të duhet të kishin pëlqimin e pylltarisë Sharri dhe Agjencionit të Privatizimit në mënyrë që të jenë në gjendje ta bartin atë. Tani, në mënyrë specifike pasi që ishte kompetence e të pandehurit, për sektorin e pronës dhe ligjor, ai ishte i obliguar që të kërkoj, para bartjes, një vlerësim të bartjes së pronës që të sigurohet së është në pajtim me interesin publik.

7. Dënimet për të Pandehurit

Duke marrë parasysh pleqërimin në lidhje me secilën pikë të akuzës dhe secilin të pandehur veç e veç, Trupi Gjykses ka arritur në përfundim që të caktojë dënimet siç edhe ceket në dispozitiv. Pas analizimit të të gjitha provave, Trupi Gjykses mori vendim që të caktojë dënim të vetëm për sa i përket R.M., duke marrë parasysh që të katër pikat e akuzës si Vepra Penale e Shpërdorimit të Detyrës Zyrtare ose Autoritetit në vazhdimësi sipas Nenit 81 të Kodit Penal, në mënyrë me specifike Trupi Gjykses konsideron se pikat 1.2 dhe 1.3 të të njëjtit Nen janë përmbushur.

Trupi Gjykses konsideron se i pandehuri **M.**ka pozitën më lartë në hierarki në komunë, pra, duke vlerësuar përgjegjësinë, Trupi Gjykses mendon se gjatë secilës pikë të akuzës i pandehuri ishte në dijeni me situatën dhe veprimet e tij nuk ishin në pajtim me kërkesat ligjore. Deri sa në veprimin e parë të shpërdorimit duke mos e

ekzekutuar aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Trupi Gjykues pajtohet me faktin se në mënyrë specifike zyra e Kadastrit ishte dashur të bëjë ndryshimet, sidoqoftë, Kryetari i Komunës kishte dijeninë dhe obligimin që të sigurohet dhe të behet ekzekutimi, pra, barra më e rëndë bie mbi të. Për sa i përket aktit të dytë si dhe të tretin, duke lëshuar me qira tokën komunale Qendrës Edukative Gulistan dhe Fabrikës së Çokollatës “Kamila” i pandehuri **M.**ka vepruar shume qartë në kundërshtim me procedurat duke mos e marrë pëlqimin e kuvendit komunal ose APK-së. Është shumë e qartë për Trupin Gjykues se **M.**ishte në dijeni për shkeljet, sidoqoftë ai vendosi që të procedoj me tutje duke pretenduar një përfitim më madhor.

Akti i fundit i të pandehurit **M.**, Konkluzioni i cili ndalonte ekspertët e kadastrit për të marrë pjesë në seanca dhe të jepe mendime, ishte konsideruar si shkelje e rëndë, duke hyrë në kompetencat e gjykatave të rregullta, pra ndalimin e rrjedhës normale të procedurës në gjykatë.

Pra, duke i marrë të gjitha parasysht, Trupi Gjykues mori parasysht të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe erdhi në përfundim që të shqiptoj dënim me kusht prej dy vitesh burgim, i cili nuk do të ekzekutohet për periudhë kohore prej 3 vitesh si periudhë verifikuese si dhe dënim plotësues mbi ndalimin e ushtrimit të detyrës në administratë publike ose funksion në shërbime publike për periudhë kohore prej 30 muajsh.

I pandehuri **S.P.**, ishte i kyçur në aktin e tretë të keqpërdorimit të detyrës zyrtare së bashku me Kryetarin e Komunës. Është shumë e qartë për Trupin Gjykues se toka e cila i ishte ndarë fabrikës së çokollatës ishte dhënë në mënyrë të kundërligjshme siç atribuohet nga Ligji mbi ndarjen e tokës publike, procedurë që duhet të ndiqet dhe ai, në fakt nuk e kishte lexuar kontratën e cila ishte nënshkruar nga ai.

Sidoqoftë, Trupi Gjykues konsideron se i pandehuri ka pasur detyrim ligjor që të jetë i vetëdijshëm për procedurën mbi ndarjen e tokës publike dhe ai është dashur të bëjë përpjekje të duhura dhe të ndjekë procedurat siç thotë ligji. Trupi Gjykues nuk i besoi pretendimit të të pandehurit dhe konsideron se dënimi i shpallur për të pandehurin **P.** si pasojë e caktimit të dënimit me kusht prej 8 muajsh burg me ekzekutim të pezulluar për periudhë kohore prej 2 vitesh verifikimi, nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale si dhe ndalimin e ushtrimit të detyrës në administratë publike ose funksion në shërbime publike për periudhë kohore prej dymbëdhjetë (12) muajsh.

I pandehuri A.A. ishte dënuar me dënim me burg prej 5 muajsh me ekzekutim dënimi të pezulluar për periudhë kohore prej 18 muajsh si periudhë verifikimi nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale për periudhën verifikuese.

Pozita zyrtare e Ushtruesit të Detyrës së Drejtorit të Drejtorisë së Kadastrit dhe Gjeodezisë për Komunën e Prizrenit , si dhe shkollimi i tij si jurist , për Trupin Gjykses është e mjaftueshme që ai të shpallet i përgjegjshëm se kishte mbështetur së bashku me Kryetarin e Komunës dhe të pandehurin M.K., ndarjen e tokës Qendrës Edukative Arsimore QEA “Gulistan” . Pasi që ishte marrë vendimi nga Kryetari i Komunës që të ndahet toka për qendrën arsimore, zyra e kadastrit ishte përgjegjëse që të mbante një njoftim publik për së paku pesë ditë pune. Trupi Gjykses konsideron se rrethanat lehtësuese në lidhje me të pandehurin **A.**, si zyrtarë i cili vetëm se e ekzekutoj vendimin tashme të marrë nga Kryetari i Komunës, sidoqoftë, për Trupin Gjykses, ai ishte i vetëdijshëm se vendimi dhe ndarja e tokës ishte bërë në një procedurë tepër të shpejtë, brenda katër orëve dhe se nuk është ndjekur procedura që pasonte pas ndarjes së tokës, e që të bëhet një njoftim publik siç kërkohet me ligj.

I pandehuri K.U. konfirmoi njëjtë si Kryetari i Komunës në pikën e parë të akuzës për Shpërdorim të detyrës zyrtare duke mos e ekzekutuar vendimin e Gjykatës Supreme në lidhje me tri parcelat e përmendura më lart. Pretendimet e të pandehurit se kishte pengesa në ekzekutimin e aktgjykimit nuk e bindën Trupin Gjykses, deri sa ishte evidente se aktgjykimi ishte i prerë dhe i ekzekutueshëm bile edhe për avokatin publik komunal e poashtu edhe për të pandehurin **A.** Trupi Gjykses mori si rrethanë lehtësuese moshën e të pandehurit si dhe gjendjen e tij shëndetësore për nevojën që ai të kryej dializën dy herë në javë dhe vendosi që të shqiptoj një dënim me kusht prej 8 muajsh burg me ekzekutim të këtij dënimi të pezulluar për periudhë kohore prej 20 muajsh si periudhë verifikimi, nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit.

Trupi Gjykses gjeti se më së paku përgjegjës në të tërë çështjen ishte i pandehuri **A.T.** i përfshirë në pikën katër të Aktakuzës, në lidhje me lëshimin e Konkluzionit. Është qëndrim i Trupit Gjykses se ideja e konkluzionit ishte nxitur dhe lëshuar nga dy të pandehurit e tjerë, Kryetari i Komunës, si dhe M.K.. Sidoqoftë, pas lëshimit, i pandehuri **T.**, nuk ishte dashur ta lejoj vendimin të shpërndahet tek stafi i tij, duke e ditur se vendimi ishte i kundërligjshëm. Trupi Gjykses vendosi të shqiptoj dënim të lehtë, duke marrë parasysh rrethanat lehtësuese se ai ishte aktiv në marrjen e vendimit dhe se kishte vizituar gjykatën dhe kryetarin e saj në mënyrë që të gjendet një zgjedhje. Dënimi me kusht prej një muaji, duket të jetë i përshtatshëm për Trupin Gjykses, për 1 vit periudhë verifikuese.

I pandehuri i fundit M.K. ishte dënuar me dënim prej 1 vit e 6 muaj burg me ekzekutim të pezulluar për periudhë kohore prej 2 viteve dhe ndalim ushtrimi të administratës publike ose funksioneve në shërbimin publik për 18 muaj. Trupi Gjykses është i mendimit se i pandehuri në cilësinë personit zyrtar, dhe atë, të Drejtorit të Drejtorisë së Administratës/Zyrës për Pronë dhe Çështje Ligjore të

Komunës së Prizrenit, ishte në dijeni se ndarja e tokës për fabrikën e çokollatës ishte bërë në mënyrë të kundërligjshme, por ai prapë se prapë e udhëzoi A.A. që të bart pronësinë e tokës para se ai të merrte pëlqim nga Kuvendi Komunal. Në lidhje me pikën e katërt të akuzës që ka të bëjë me propozimin që të lëshohet Konkluzioni që të ndaloj ekspertët e kadastrit, erdhi nga M.K.. Si person zyrtar ai e dinte se këto ftesa të gjykatës duhet të respektohen dhe që të adresohen nga gjithë secili. Për Trupin Gjykses është më se evidente se M.K. përdorte pozitën e tij dhe autoritetin duke qenë i pa kujdesshëm në punën e gjykatës, kështu që e pengoi rrjedhën e procedurës.

Gjykata pret nga një dënim i tillë, sinjal për shoqërinë se zyrtarët nuk mund të injorojnë dhe shkelin ligjin edhe nëse është me qëllim të mirë. Në anën tjetër, përfitimi personal nga veprat penale për të pandehurin nuk ishte provuar si dhe jeta e mëhershme e tyre e mirë duhet të merret parasysh. Mos vet - reflektimi i R.M. bën thirrje për periudhë më të gjatë testuese dhe për dënim më të rëndë, por gjykata është e mendimit se një masë kaq e rëndë është mjaft e siguruar nga ndalesa e ushtrimit të punës në administratë publike ose shërbime publike. Ky mendim nuk mund implikohet në rastin e të pandehurve të tjerë, përveç M.K. dhe **S. P.** Të pandehurit **M.** dhe **K.** vepruan në më shumë se një rast. Pozitat e tyre në menaxhmentin e komunës ishin vendimtare. Pozita e **S. P.** nuk mund të krahasohet me pozitën e R.M. në hierarkinë komunale, por pjesa e tij në përgjegjësi në shkeljen e rëndë të ligjit në Fabrikën Kamila, mundet poashtu të meritojë dënim plotësues, që do të ndalonte atë të ketë funksion publik për periudhë kohore prej një viti siç edhe përshkruhet në Nenin 54 paragrafët 1,2 dhe 56, paragrafi 2 i kodit të vjetër penal. (Gjykata është e bindur në bazë të interpretimit të nenit 54 paragrafi 1 dhe 2 të kodit të vjetër penal se Neni 56 lejon caktimin e dënimit mbi ndalimin e ushtrimit të punës në administratë publike ose shërbime publike e edhe dënimi më burg është i pezulluar edhe pse kodi i vjetër penal e përmend në Nenin 56 paragrafin 2 se ekzekutimi i një dënimi të tillë pas vuajtjes së dënimit me burg dhe ndalimi i ushtrimit të punës në administratë publike ose shërbim publik, shkon në të njëjtën kohë me periudhën me kusht apo testuese.

Duke i marrë të gjitha parasysh, Trupi Gjykses vendosi për dënimet për të pandehurit.

Kërkesë paditë e palëve të dëmtuara

Kërkesat e palëve të dëmtuara kanë nevojë për më shumë procedurë rreth provave për kompensimin e mundshëm të palëve të dëmtuara. Hollësi të tilla të provave dhe procedurës tejkalon nevojat e gjykimit penal për këtë arsye palët janë të këshilluar që të paraqesin një kërkesë civile për kompensim.

Shpenzimet

Të pandehurit obligohen të paguajnë të gjitha shpenzimet për procedurën penale në shumë prej 1200 Eurosh. Obligimi i të pandehurit kufizohet në shumën prej 200 Eurosh për secilin nga ata.

Në pajtim me Nenin 463 paragrafin 2 të Kodit të procedurës penale , Ministria e Drejtësisë, Komuna e Prizrenit, Agjensioni Kosovar i Privatizimit, Organizata e Pyltarisë Sharri, udhëzohen që të ndjekin padinë e tyre nëpërmes procedurës gjyqësore civile.

GJYKATA THEMELORE E PRIZRENIT P.Nr. 171/13; PP.Nr. 147/2011, Data: 13 Mars 2014

Kryetar i Trupit Gjyqësor
Vladimir Mikula

Procesmbajtësja
Sonila Macneil

Mjetet ligjore:

Në pajtim me Nenin 380 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, mund të parashtrohet ankesë kundër këtij aktvendimi brenda 15 ditëve nga dita kur një kopje e këtij Aktgjykimi u është dhënë palëve. Ankesa duhet të i drejtohet Gjykatës së Apelit përmes Gjykatës Themelore të Prizrenit.